

RAPORT MONITORIMI
PËR ZBATUESHMËRINË E STRATEGJISË KOMBËTARE TË RINISË 2022-2029
PERIUDHA: JANAR-QERSHOR 2024

Tabela e përmbajtjes

1.	Informacioni përmbledhës	3
1.1	Reforma të implementuara me sukses në vitin përkatës.....	5
1.2	Impakti i zhvillimit të sektorit në rajon/ose më gjerë.....	6
1.3	Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e Integritimit Evropian.....	6
1.4	Komponentët që kanë nevojë për adresim me qëllim përmirësimin e implementimit	7
1.5	Ekzekutimi i përgjithshëm i masave të strategjisë	7
2.	Progresi i lidhur me qëllimet politike, objektivat specifike dhe masat	8
	QËLLIMI POLITIK I.....	8
	QËLLIMI POLITIK II.....	21
	QËLLIMI POLITIK III.....	42
3.	Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit	55
4.	Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve, risqeve dhe hapat për të adresuar.....	59
5.	Konkluzione dhe rekomandime	60
6.	Hapat e radhës	61

1. Informacioni përmbledhës

Në vijim të Ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë”, i cili siguron bazën ligjore për hartimin e politikave dhe programeve strategjike për rininë, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët (MSHRF), në bashkëpunim me anëtarët e grupit të punës ndërministror, kanë hartuar Strategjinë Kombëtare të Rinisë (SKR), si dhe Planin e Veprimit 2022-2029, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 692, datë 26.10.2022. Ky dokument strategjik ka kaluar në një proces koordinimi dhe konsultimi me ministritë e linjës përgjegjëse, institucionet e tyre të varësisë, institucionet e pavarura përkatëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizatat e shoqërisë civile që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e rinisë, punonjësit rinorë të vendosur pranë cdo bashkie, anëtarët e KVR-ve dhe KKR-së, si dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Gjithashtu, kjo Strategji ka kaluar në një proces konsultimi të gjerë me të rinjtë në çdo cep të Shqipërisë, të cilët nga gushti i vitit 2021 deri më shkurt të vitit 2022, kanë pasur mundësi të ngrejshë shqetësimet e tyre, duke i thënë problematikat që kanë në përditshmëri në zonat ku jetojnë. Ata shprehën idetë dhe mendimet që mund t’ju japin zgjidhje kërkesave të tyre.

Bazuar në rregullat e hartimit të dokumentave politikë, ky dokument është vendosur në regjistrin e konsultimit publik si dhe është prezantuar në Këshillin Konsultativ Qeveri Qendrore-Vetëqeverisje Vendore, përpara miratimit me VKM.

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 përcaktohet në pjesën e saj të katërt “Zbatimi, Llogaridhënia dhe Koordinimi”, ku parashikohet se, zbatimi efektiv dhe i suksesshëm i SKR 2022-2029 do të arrihet përmes një sistemi monitorimi dhe vlerësimi për të verifikuar progresin në plotësimin ose jo të objektivave specifike dhe masave të vendosura në Planin e Veprimit. I gjithë procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të menaxhohet përmes Komitetit Drejtues Sektorial për Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, siç parashikohet në Urdhrin e Kryeministrit Nr. 157 datë 22.10.2018 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, dhe krijimin e funksionimit të një mekanizmi të integruar sektorial/ndërsektorial”.

MSHRF ka rol koordinues dhe raporton në mënyrë periodike mbi ecurinë e zbatimit të SKR-së çdo gjashtë muaj dhe çdo vit. Raportet e monitorimit do të hartohen në bashkëpunim me të gjitha institucionet e përfshira si dhe do të diskutohen në grupet tematike të krijuara për këtë qëllim sipas objektivave specifike të SKR 2022-2029 dhe më pas miratohen në Komitetin Drejtues Sektorial për sektorin e rinisë. Sipas SKR-së, secili institucion raporton mbi nivelin e zbatimit të secilit objektiv dhe masë, mbi buxhetin e alokuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në përgjithësi.

MSHRF do të përdorë metodologjinë e monitorimit të bazuar në standardet IPSIS që do të përcaktojnë se si do të kryhet procesi i monitorimit dhe vlerësimit me qëllim krijimin e një sistemi efektiv, të unifikuar dhe sistematik të raportimit të të dhënave të të gjithë institucioneve të përfshira në zbatimin e sistemit IPSIS.

Siç paraqitet edhe në mënyrë më të zgjeruar në këtë raport monitorimi, gjatë periudhës janar – qershor 2024 janë shënuar një sërë zhvillimesh dhe arritjesh të rëndësishme në fushën e rinisë, në kuadër të përmbushjes së tre qëllimeve politike që qëndrojnë në bazë të SKR-së.

Ka filluar zbatimi i masave për objektivat e parashikuar në Planin e Veprimit ndërkohë që duhet theksuar që zbatimi i tyre në pjesën më të madhe ka një shtrirje kohore të gjatë që përkon me vitin e fundit të Strategjisë, duke siguruar kështu vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë ndër vite të prioritizimit të masave që synojnë përmirësimin e situatës së të rinjve në Shqipëri, duke u ofruar mundësi të barabarta me të rinjtë europianë, duke u krijuar mundësi për arsim cilësor dhe përfshirje në tregun e punës shqiptar dhe atë ndërkombëtar.

Gjatë kësaj periudhe ka vijuar ndërmarrja e hapave konkretë për zbatimin e masave, sipas rolit dhe përgjegjësisë të institucioneve të përfshira në këtë proces, si institucion udhëheqës apo kontribues, duke vendosur shtyllat e bashkëpunimit me të gjithë aktorët dhe faktorët, përfshirë dhe ata të jashtëm, ku një rol të veçantë e kanë edhe organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ndërkohë nga monitorimi i detajuar i zbatimit të masave të parashikuara në SKR 2022-2029, për periudhën janar 2024 - qershor 2024 rezultoi se:

Për periudhën raportuese është parashikuar fillimi i zbatimit të tre Qëllimeve Politike, 9 Objektivave Specifikë dhe 44 masa, nga të cilat 16 masa për QPI, 13 për QPII dhe 15 për QPIII.

MSHRF dhe AKR raportojnë për zbatimin e 42 nga masat që përbëjnë 95 % të masave të parashikuara, për të cilat janë raportuar hapat e ndërmarrë, me qëllim zbatimin e tyre. Ndërkohë, 2 nga masat e pa raportuara përbëjnë 5 % të masave të parashikuara.

Qëllimi politik I: Të rejtat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financiar.

Ky qëllim politik ka të parashikuar 3 Objektivat Specifikë dhe konkretisht Objektivin Specifik 1.1, me 9 masa, Objektivin Specifik 1.2, me 4 masa dhe Objektivin Specifik 1.3, me 3 masa. Për sa i përket raportimit mbi zbatimin e këtyre masave rezultoi se, për 15 masa është raportuar fillimi i zbatimit.

Qëllimi politik II: Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.

Ky qëllim politik ka të parashikuar 3 Objektivat Specifikë dhe konkretisht Objektivin Specifik 2.1, me 6 masa, Objektivin Specifik 2.2, me 3 masa dhe Objektivin Specifik 2.3, me 4 masa. Për sa i përket raportimit mbi zbatimin e këtyre masave rezultoi se, për 12 masa është raportuar fillimi i zbatimit.

Qëllimi politik III: Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social.

Ky qëllim politik ka të parashikuar 3 Objektiva Specifikë dhe konkretisht Objektivi Specifik 3.1, me 7 masa, Objektivi Specifik 3.2, me 5 masa dhe Objektivi Specifik 3.3, me 3 masa. Për sa i përket raportimit mbi zbatimin e këtyre masave rezulton se, për 15 masa është raportuar fillimi i zbatimit.

Informacion dhe të dhëna për sa më sipër, përfshirë nivelin e rezultateve dhe treguesve të objektivave të përmbushur, parashtrihen në vijim.

1.1 Reforma të implementuara me sukses në vitin përkatës

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 dhe Plani i Veprimit përbëjnë dokumente strategjike, të cilat synojnë marrjen e masave dhe zhvillimin e aktiviteteve të shumta për arritjen e qëllimeve të mëposhtëm:

Të rejtat dhe të rinjtë marrin pjesë në mënyrë aktive në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërat e tyre.

Për përmbushjen e këtij qëllimi janë marrë masa për forcimin e mekanizmave të pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje. Ngritja e Këshillave Vendorë Rinor si një iniciativë e rëndësishme për përfshirjen e të rinjve në proceset vendimarrëse në nivel vendor, ka qenë në fokus të punës së MSHRF-së dhe AKR-së. Përmes nxitjes, shkëmbimit të informacionit, praktikave më të mira dhe dhënies së udhëzimeve sipas nevojave dhe kërkesave të bashkive, janë ngritur këshillat vendorë rinorë në përputhje me parashikimet e të Ligjit nr. 75/2019, “Për Rininë” në të gjithë vendin. Në bashkëpunim me Bashkinë e Vaut të Dejës në datë 6 Mars 2024 u krijua edhe KVR për këtë qytet. Me krijimin e KVR-së së Vaut të Dejës u finalizua krijimi i 61 KVR-ve në gjithë vendin.

Ndërkohë, në kuadër të procesit të dhënies së granteve për projekte rinore, gjatë periudhës raportuese ka nisur zbatimi i projekteve fituese të Thirrjes së Tretë. Përmes rritjes së grantit për organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë është siguruar efektiviteti i lartë dhe transparencë në menaxhimin e thirrjeve për projekt-propozime rinore, nëpërmjet metodologjisë LOD, një nga praktikatat më të suksesshme në BE për financimin e organizatave të shoqërisë civile, që siguron transparencë, efektivitet dhe gjithë përfshirje në të gjithë hallkat e këtij procesi¹. Gjithashtu, është hapur Thirrja Publike nr. 4, në datë 16 Prill 2024 për mbështetjen e organizatave rinore/ për të rinjtë për të cilën po vijon procesi i negociimit me OSHC-të.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022–2029 i kanë kushtuar një rëndësi të veçantë mbështetjes ndaj Njësive të Vetqeverisjes Vendore si aktorë të rëndësishëm dhe kryesorë në ofrimin e shërbimeve në nivel lokal. Financimi i qëndrueshëm i tyre shihet si një mekanizëm i domosdoshëm në realizimin e iniciativave dhe programeve që synojnë zhvillimin e rinisë nëpërmjet ndërtimit, riparimit dhe rinovimit të hapësirave publike të projektuara për të rinjtë, me qëllim përmirësimin e qasjes së tyre në hapësira të sigurta takimi në kohën e lirë.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë nëpërmjet thirrjes III për projekt-propozime për infrastrukturë rinore nga Njësiti e Vetë Qeverisjes Vendore (NJVV), me një fond në dispozicion prej 50 milion lekësh ka financuar rikonstruksionin, ndërtimin,

¹ Metodologjia LOD (Përforcimi i Demokracisë Lokale), pjesë e Programit Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD2)

rindërtimin dhe vënien në funksion të qendrave rinore në Bashkitë Mat, Sarandë, Malësi e Madhe, Fier, Korçë dhe Librazhd.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë me qëllim nxitjen e zhvillimit të një mjedisi shkollor përkrahës për të gjithë nxënësit dhe mbështetjen për bërjen sa më aktive e Këshillave Studentore/Qeverive të Nxënësve dhe organizimeve të tjera të nxënësve, ka vijuar mbështetjen e zhvillimit të mekanizmave për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave mes organeve përfaqësuese të nxënësve, studentëve, organizatave rinore dhe qendrave rinore, me mbështetjen e qeverisë dhe organizatave përfaqësuese rinore.

Me qëllim forcimin e aftësive institucionale në përmbushjen e funksioneve dhe detyrave të tij në mënyrë më efektive, efikase dhe të qëndrueshme si dhe rritjen e ndikimit pozitiv dhe afatgjatë në shoqëri, përmes Urdhërit Nr. 58 datë 18.04.2024 "Për miratimin e Strukturës së Agjencisë Kombëtare të Rinisë" të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë u miratua ristrukturimi i AKR-së si dhe rritja e numrit të punonjësve të saj në 30. Fuqizimi i roleve zbatuese, koordinuese, monitoruese të AKR përmes rritjes së kapaciteteve financiare dhe njerëzore mundëson zbatimin me më shumë efikasitet të politikave sektoriale për rininë të pasqyruara në SKR 2022-2029.

1.2 Impakti i zhvillimit të sektorit në rajon/ose më gjerë

Forumi Rinor Evropian është platforma më e gjerë e organizatave rinore në Evropë, e cila përfaqëson mbi 100 organizata rinore, duke sjellë më pranë dhjetëra milionë të rinj nga e gjithë Europa. Forumi Rinor Evropian financohet nga Fondacioni Rinor Evropian, Këshilli i Evropës, si dhe Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian.

Indeksi i Progresit Rinor, i hartuar nga Forumi Rinor Evropian në bashkëpunim me "Social Progress Imperative", është instrumenti më shterues matës i mirëqënies së të rinjve në botë.

Ky Indeks identifikon dhe analizon të dhënat mbi aspekte thelbësore të mirëqënies së të rinjve, si aksesimi në mirë-ushqyerje, strehim, shërbime shëndetësore, mundësi për të ushtruar të drejtat e tyre vendimmarrëse dhe politike, gjithëpërfshirje, mos-diskriminim etj.

1.3 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e Integritimit Evropian

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2022-2024 e vendos si prioritet të tij rininë, si edhe miratimin e Strategjisë së Rinisë brenda tremujorit të tretë të vitit 2022. Miratimi i SKR-së në tetor të vitit 2022 është një impenjim i përmbushur dhe përfshirja e çështjeve të rëndësishme për rininë, si gjithëpërfshirja, arsimit dhe kultura, janë pjesë e zbatimit të angazhimit në kuadër të agjendës së integritimit evropian.

Gjatë periudhës raportuese rezultoi se, ka vijuar zbatimi i pjesës më të madhe të masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë, të cilat rezultojnë të jenë trajtuar edhe në Kapitullin 26 "Arsimi dhe Kultura", të PKIE 2022-2024.

Kështu, adresimi nëpërmjet parashikimit dhe zbatimit të masave të caktuara në drejtim të çështjeve të tilla si, arsimit cilësor, këshillimi për karrierën, punësimi, përfshirja në vendimmarrje,

gjithëpërfshirja, mirëqënia e të rinjve, në aspektin fizik e shëndetësor, social dhe mendor, novacioni dhe investimi në këtë fushë i të rinjve, siguria dhe mbrojtja, angazhimi i të rinjve në aktivitete argëtuese dhe edukative, në arte e zeje, veprimtari sportive etj., është në përputhje me agjendën e integrimit evropian, duke sjellë një impakt pozitiv në zbatimin e të dy dokumenteve strategjike.

Implementimi me sukses i masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë dhe përafrimi i tyre me agjendën e integrimit në Bashkimin Evropian, ndihmon në përmbushjen e prioritetëve të integrimit dhe përmbushjen e kriterëve thelbësore dhe të nevojshme për funksionimin si një shtet me parime Evropiane.

1.4 Komponentët që kanë nevojë për adresim me qëllim përmirësimin e implementimit

Referuar ecurisë së realizimit të masave të parashikuara në Planin e Veprimit për secilin Objektiv Specifik konstatohet se, pjesa më e madhe e objektivave specifike ka nivel zbatueshmërie të kënaqshëm, duke marrë në konsideratë edhe faktin që ky raport monitorimi është 8 muajor, në një Strategji Kombëtare ku zbatimi i pjesës më të madhe të masave shtrihet në një periudhë afatgjatë 2022/2023-2029.

Gjithsesi në vijim pasqyrohen rezultatet e monitorimit të Strategjisë nga AKR për periudhën raportuese dhe konkretisht rezulton se, është e nevojshme intensifikimi i punës në realizimin e objektivave specifike të mëposhtëm:

Objektivi specifik 1.1 rezulton se ka 2 masa të pa realizuara.

Objektivi specifik 1.3 rezulton se ka 1 masë të pa realizuar.

Objektivi specifik 2.3 rezulton se ka 1 masa të pa realizuar.

Objektivi specifik 3.1 rezulton se ka 1 masë të pa realizuar.

Performanca e realizimit të objektivave specifike të sipërcituar ka ndikuar në trendin e përgjithshëm të realizimit të qëllimit politik 1, 2 dhe 3 dhe rekomandohet koordinimi i punës ndërmjet institucionit udhëheqës dhe institucioneve kontribuuese për marrjen e hapave të nevojshëm konkretë për zbatimin e masave për secilin objektiv.

1.5 Ekzekutimi i përgjithshëm i masave të strategjisë

Për periudhën raportuese, Janar 2024 – Qershor 2024, ka nisur zbatimin e tre Qëllimeve Politike, nëntë Objektivave Specifike dhe 44 masa, nga të cilat 16 masa për QPI, 13 për QPII dhe 15 për QPIII.

Për Qëllimin e Politikës I, janë raportuar 15 masa, nga të cilat 6 janë realizuar plotësisht, 7 janë realizuar pjesërisht dhe 2 janë të parrealizuara. Për Qëllimin e Politikës II, AKR si një institucion me përgjegjësi mbështetëse raporton lidhur me 12 masa, nga të cilat 6 janë realizuar plotësisht, 5 masa janë realizuar pjesërisht dhe 1 masë është e pa realizuar. Për Qëllimin e Politikës III, janë

raportuar 15 masa, ku 11 masa janë realizuar plotësisht, 3 masa janë realizuar pjesërisht dhe 1 masë është e pa realizuar. Në total, nga 42 masa të raportuara, 23 janë realizuar plotësisht, 15 janë realizuar pjesërisht dhe 4 janë të përealizuara.

STATUSI	NR. I MASAVE TË RAPORTUARA	PLOTËSISHT TË REALIZUARA	PJESËRISHT TË REALIZUARA	TË PAREALIZUARA
QËLLIMI POLITIK NR. I	15	6	7	2
QËLLIMI POLITIK NR. II	12	6	5	1
QËLLIMI POLITIK NR. III	15	11	3	1
TOTALI	42	23	15	4

Për Qëllimin e Politikës I, që përfshin 15 masa të raportuara, 40% janë plotësisht të realizuara, 47% janë pjesërisht të realizuara dhe 13% janë përealizuar, dhe 1 masë e paraportuar së bashku. Për Qëllimin e Politikës II, që përfshin 13 masa, 50 % janë plotësisht të realizuara, 42 % janë pjesërisht të realizuara dhe 8 % është e përealizuar. Për Qëllimin e Politikës III, që përfshin 15 masa, 73% janë plotësisht të realizuara, 20% janë pjesërisht të realizuara dhe 7% janë përealizuar. Në total, nga 42 masa, 55% janë realizuar plotësisht, 35% janë realizuara pjesërisht dhe 10% nuk janë realizuar ende apo janë të paraportuara.

Progresi i lidhur me qëllimet politike, objektivat specifike dhe masat

STATUSI	NR. I MASAVE TË RAPORTUARA	REALIZUESHMËRIA (PLOTËSISHT & PJESËRISHT)	PLOTËSISHT TË REALIZUARA	PJESËRISHT TË REALIZUARA	TË PAREALIZUARA
QËLLIMI POLITIK NR. I	15	87%	40%	47%	13%
QËLLIMI POLITIK NR. II	12	92%	50%	42%	8%
QËLLIMI POLITIK NR. III	15	93%	73%	20%	7%
TOTALI	42	90%	55%	35%	10%

QËLLIMI POLITIK I: Fuqizimi i organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore. Të rejtat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur

me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financiar.


Qëllimi Politik I, ka në përmbajtje të tij 3 Objektiva Specifikë dhe 16 Masa. Ky qëllim politik zbërthehet në masa që lidhen me rishikimin e legjislacionit në fuqi në fushën e rinisë, pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje, nëpërmjet ngritjes dhe fuqizimit të mekanizmave/institucioneve në nivel vendor dhe qendror, si dhe në shkolla/universitete, mbështetjes së organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e rinisë, si dhe hartimin e politikave rinore mbi baza shkencore dhe analiza faktike.

Përmbledhje për Qëllimin Politik 1

NUMRI I MASAVE	TË PARAPORTUARA	TË RAPORTUARA
16	1	15
100%	6%	94%

NUMRI I MASAVE	PLOTËSISHT TË REALIZUARA	PJESËRISHT TË REALIZUARA	TË PAREALIZUARA
15	6	7	2
100%	40%	47%	13%

Qëllimi Politik I



Më poshtë paraqitet një panoramë e detajuar mbi hapat konkretë të ndërmarrë gjatë periudhës raportuese, me qëllim realizimin e masave të parashikuara për secilin objektiv specifik.

Objektivi Specifik 1.1: Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike

Masa 1.1.1 Rishikohet Ligji për Rininë për të konsoliduar dhe zhvilluar më tej proceset e krijimit të organizatave rinore, përfaqësimin rinor, punën rinore dhe ofrimin e shërbimeve të pranueshme e miqësore për të rinjtë.

Puna për rishikimin e ligjit nr. 75/2019 “Për rininë” ka nisur në gjashtë mujorin e parë të vitit 2023, me ndërmarrjen e procesit të vlerësimit të brendshëm nga MSHRF-ja dhe AKR-ja, lidhur me zbatimin dhe ndikimin e tij, duke synuar analizën e situatës, identifikuar problematikën dhe nevojat për ndryshim në përputhje me zhvillimet e reja në fushën e rinisë.

Procesi i rishikimit të ligjit për rininë do të ndjekë të njëjtën qasje të bashkëkrijimit të zbatuar në rastin e përgatitjes së Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe do të synojë angazhimin dhe marrjen e kontributeve të aktorëve të jashtëm. Paketa e amendimeve të Ligjit nr. 75/2019 parashikohet të përgatitet, konsultohet publikisht dhe paraqitet për miratim në Këshillin e Ministrave brenda vitit 2024, në përputhje me parashikimet në Planin e Veprimit të SKR-së, si dhe raportimet përkatëse në PPAP 2024 dhe Programin Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian PKABE 2030.

Për Ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë” është zhvilluar konferenca e mbajtur në Tiranë me praninë e të gjithë të interesuarve. Është zhvilluar një tur konsultimi publik në 12 bashki të vendit, ku kanë marrë pjesë organizata jofitimprurëse, të rinj, anëtarë të KVR-së dhe KKR-së, përfaqësues nga institucionet e bashkive, punonjës rinorë, etj. Në turin konsultativ janë paraqitur rekomandimet, problematikat, ndryshimet e kërkuara për ligjin. Janë diskutuar në detaje aspektet më problematike të Ligjit sipas vlerësimit të OSHC-ve në kuadër të planit të veprimit për rishikimin e ligjit për të konsoliduar dhe zhvilluar më tej proceset e krijimit të organizatave rinore, përfaqësimin rinor, punën rinore dhe ofrimin e shërbimeve të pranueshme dhe miqësore për të rinjtë.

Masa 1.1.1 është pjesërisht e realizuar.

Masa 1.1.2 Forcohen mekanizmat (në nivel qendror dhe vendor) për të garantuar pjesëmarrjen dhe konsultimin e të rejave apo të rinjve në vendim-marrje.

Për përmbushjen e këtij qëllimi janë marrë masa për forcimin e mekanizmave të pjesëmarrjes së të rinjve në vendim-marrje. Ngritja e Këshillave Vendorë Rinor si një iniciativë e rëndësishme për përfshirjen e të rinjve në proceset vendimarrëse në nivel vendor, ka qenë në fokus të punës së MSHRF-së dhe AKR-së. Përmes nxitjes, shkëmbimit të informacionit, praktikave më të mira dhe dhënies së udhëzimeve sipas nevojave dhe kërkesave të bashkive, janë ngritur këshillat vendorë rinorë në përputhje me parashikimet e të Ligjit nr. 75/2019, “Për Rininë” në të gjithë vendin. Në bashkëpunim me Bashkinë e Vaut të Dejës në datë 6 Mars 2024 u krijua edhe KVR për këtë qytet. Me krijimin e KVR-së së Vaut të Dejës u finalizua krijimi i 61 KVR-ve në gjithë vendin.

Forcimi i mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për të garantuar pjesëmarrjen e të rinjve në vendim-marrje, përforcimi i kapaciteteve dhe aftësive të Këshillit Kombëtar të Rinisë (KKR) dhe Këshillave Vendor Rinor (KVR) për konsultimin dhe përfaqësimin e të rinjve, është një hap i rëndësishëm. Në kuadër të kësaj nisme ka nisur puna për hartimin e një Manuali të përditësuar mbi Këshillat Vendorë Rinor dhe trainimin e KVR-ve bazuar dhe në bashkëpunimin e vazhdueshëm midis AKR dhe World Vision.

Përgjatë muajit Mars 2024, MSHRF dhe AKR zhvilluan mbledhjen me Këshillin Kombëtar të Rinisë për të diskutuar dhe propozuar për zgjidhje disa çështje, siç është ndërveprimi i KKR-KVR, si dhe fuqizimi i KKR për të qenë më pranë të rinjve. Gjatë këtij takimi u diskutua mbi Ligjin e Rinisë dhe vullnetarizmin.

Me qëllim ndërveprimim, mbledhjen e informacionit, evidentimin e problematikave dhe rritjen e kapaciteteve të KVR-ve, gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar takime në platformën Zoom. Janë finalizuar takimet online me të gjitha bashkitë e qarqeve të Shqipërisë.

Në kuadër të Javës së Shoqërisë Civile më datë 31 Maj, AKR mori pjesë në panelin e organizuar nga Partners Albania, i cili kishte në fokus përmirësimin e bashkëpunimit dhe koordinimit midis palëve të interesit. Aty u theksua se një ndër risitë dhe prioritetet e AKR-së është informimi i çdo të riu lidhur me mundësitë për përfshirje dhe aktivitetet rinore.

Me mbështetjen e MSHRF-së, në bashkëpunim me Dekanatin dhe stafin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe Qendrën e Shkollës së Drejtorëve, AKR organizoi në 15 Maj ceremoninë e shpërndarjes së certifikatave për 40 të rinjtë e talentuar të konkursit eseistik, i cili evidenton dhe promovon talentet e të rinjve.

Me qëllim rritjen e efektivitetit të strukturave të Këshillave Vendore Rinore në bashkëpunim me World Vision ka nisur puna për hartimin e një Manuali të përditësuar mbi Këshillat Vendorë Rinorë dhe trajnimin e KVR.

Paralelisht me procesin e ngritjes së KVR-ve, MSHRF-ja dhe AKR-ja kanë mbështetur ngritjen e kapaciteteve të këshillave vendor përmes organizimit të Workshopeve/trajnimeve në bashkëpunim me donatorë të huaj/OSHC-të rinore.

Në thirrjen publike NR. III për projekt-propozime për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, është financuar organizata New Bridges në kuadër të projektit "Pjesëmarrja e të rinjve në vendimarrje modelon të ardhmen". Në datë 7 Prill 2024 zhvilloi në bashkinë Dimal workshopin 2 ditor me titull "Zbatimi i planeve dhe politikave rinore në nivel vendor" ku morën pjesë punonjësit rinorë të bashkisë, anëtarët e KVR-së, anëtarët e Këshillit Bashkiak dhe të rinjtë e grupit rinor. Ky aktivitet kishte për qëllim zhvillimin e kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit/politikave kombëtare në nivel lokal, ndarjen e eksperiencave që të identifikohen/adresohen nevojat e të rinjve nëpërmjet politikave/aktiviteteve rinore lokale dhe njohjen me "Ligjin e Rinisë", Strategjinë Kombëtare të Rinisë dhe Planin e Veprimit.

Në kuadër të projektit global "World Class", i cili ka si qëllim trajnimin e të rinjve lidhur me soft-skills, orientimin e tyre drejt karrierës si dhe ofrimin e ndihmës në fushën e sipërmarrjes, në datë 31 Maj 2024 u nënshkrua marrëveshja midis AKR dhe Deloitte Albania & Kosovo. Kjo marrëveshje ka në fokus trajnimin e të paktën 3 KVR-ve në fushën e aftësive të buta, edukimit ligjor, financiar, etj.

Në kuadër të Thirrjes nr. III për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, është financuar nga MSHRF dhe AKR Shoqata "LIBURNETIK", e cila ka zhvilluar projektin me titull "Re-Debate, Kampionati Kombëtar i Debatit" me synim përfshirjen e 940 të rinjve në 21 bashki, Malësi e Madhe, Shkodër, Kukës, Mirditë, Lezhe, Dibër, Mat, Krujë, Durrës, Tiranë, Kamëz, Elbasan, Patos, Pogradec, Korçë, Berat, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë, Konispol. Nëpërmjet këtij

projekti janë realizuar trajnime të vazhdueshme me të rinj të shkollave të mesme me qëllim nxitjen e aftësive të debatimit, lidërshiptit, mendimit kritik dhe argumentimin e temave të ndryshme. Në kuadër të Thirrjes Nr. III për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, është financuar nga MSHRF dhe AKR, shoqata Media dhe Çeshtjet Shoqërore e cila zbatoi projektin “GenZ” ku u synua përfshirja e 20 të rinjve në 10 puntata me nga 2 debate pro dhe kundër secila, në bashkitë Tiranë + Vorë, Kamëz.

Masa 1.1.2 është e realizuar

Masa 1.1.3 Përmes platformës rinore “Të rinjtë për të Rinjtë” dhe formave të tjera të komunikimit social shpërndahen informacione dhe udhëzues për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendim-marrje 2023-2029.

Masa 1.1.3 është e porealizuar

Masa 1.1.4 AKR mbështet me anë të një programi grantesh organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore përmes ngritjes së infrastrukturës për qendra rinore, biblioteka dhe hapësira për të rinjtë.

Gjatë periudhës raportuese, Janar - Qershor 2024, ka vijuar zbatimi i projekteve fituese të Thirrjes publike Nr. III për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, si edhe Thirrjes Nr. III për projekt-propozime për infrastrukturë rinore nga Njësitë e Vetë Qeverisjes Vendore (NJVV). Gjithashtu është hapur Thirrja publike Nr. IV për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë.

Referuar Thirrjes Nr. III për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë po vazhdon mbështetja për realizimin e implemetimit të 20 projekteve të financuara nga AKR dhe 3 projekteve të financuara nga donatorë. Nëpërmjet saj kanë përfituar dhe vazhdojnë të përfitojnë në mënyrë direkte dhe indirekte rreth 7000 të rinj.

Gjatë periudhës raportuese vijon monitorimi i thirrjes Nr. III për projekt-propozime për infrastrukturë rinore nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) e cila u hap në datën 8 Dhjetor 2023 deri më 7 Janar 2024. Totali i aplikimeve të projekt - propozimeve nga NJVV-të në këtë thirrje është 32. Buxheti i vënë në dizpozicion për këtë thirrje për mbështetje financiare nga AKR për NJVV-të është 50 milion lekë.

Nëpërmjet Thirrjes Nr. III MSHRF dhe AKR në përputhje me prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, janë shpallur fituese 6 (gjashtë) bashki, të cilat do të mbështeten financiarisht nga AKR me fokus ndërtimin apo rikonstruksionin e objekteve publike dhe infrastrukturës rinore, përkatësisht:

1. Bashkia Mat - “Rinovart Qendër rinore multifuksionle, rekreative, inovacion dhe art”
2. Bashkia Sarandë – “Qendra Rinore Sarandë”
3. Bashkia Malësi e Madhe – “Kompleksi Rinor “Syri i Sheganit”
4. Bashkia Fier - “Skyhigh Rinor: Projekti i hapësirës së Rinisë që Shkëlqen mbi Qytet”
5. Bashkia Korçë - “Rehabilitimi i Qendrës Rinore Korçë”
6. Bashkia Librazhd – “Ndërtimi i një qendre rinore në Bashkinë Librazhd”

Në 7 Mars MSHRF dhe AKR nënshkruan kontratat me bashkitë e shpallura fituese. Nëpërmjet mbështetjes me grante për 6 NJVV, është synuar mbështetja dhe ndikimi pozitiv në jetën e rreth 108,233 të rinjve.

Në zbatim të ligjit nr.75/ 2019 “Për rininë”, VKM nr. 681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë”, si edhe konform ndryshimeve ligjore, diktuar nga VKM nr. 566 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë”, Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) ka publikuar Thirren Nr. IV për projekt-propozime për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë u hap në datën 16 Prill 2024 deri më 17 Maj 2024 duke vendosur në dispozicion të të gjithë kandidatëve të interesuar paketën me dokumentacionin e konkurrimit për projekt-propozime rinore. Thirrja e IV e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, synoi të adresojë prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 sipas fushave të përparësisë:

1. Nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe mbështetja e aktivizimit shoqëror dhe qytetar të tyre.
2. Nxitja e punëve të denja dhe ndërlidhjes së të rinjve me tregun e punës.
3. Mbështetja e mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore e të rinjve.

Buxheti i vënë në dispozicion për këtë thirrje për mbështetjen financiare nga AKR për OSHC-të është 70 milion lekë.

Totali i aplikimeve të projekt-propozimeve nga organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë në këtë thirrje ishte 117.

Pas përmbylljes së procesit të vlerësimit, AKR-ja njoftoi çdo aplikant lidhur me vlerësimin dhe pikëzimin e projekt-propozimit të tyre në thirrje. Në muajin korrik është përcaktuar nisja e procesit të negocimit me OSHC-të.

Me qëllim rritjen e informimit, Agjencia Kombëtare e Rinisë ka zhvilluar disa trajnime/sesione informuese sa i përket programeve të grant dhënies për organizatat dhe bashkitë:

- Në datë 23 dhe 24 Janar 2024 u zhvillua një takim me organizata jo-fitim prurëse rinore të cilat janë shpallur fituese të thirrjes Nr. III për grante nga AKR. Qëllimi i takimeve ishte ndërveprimi dhe bashkëpunimi për zbatimin e projekteve fituese, si dhe sqarimi i procedurave të zbatimit dhe raportimit të projekteve.
- Në datë 25 Mars është zhvilluar një sesion informues mbi implementimin e projekteve fituese të thirrjes publike Nr. III nga NJVV.
- Në kuadër të thirrjes Nr. IV për projekt propozime rinore, janë realizuar 3 sesione informuese lidhur me procedurat dhe dokumentacionin e aplikimit përkatës në datat; 30 Prill, 8 Maj, 13 Maj.

Masa 1.1.4 është e realizuar.

Masa 1.1.5 Nxitet zhvillimi i një mjedisi shkollor përkrahës për të gjithë nxënësit dhe mbështetet bërja sa më aktive e Këshillave Studentore/Qeverive të Nxënësve dhe organizimeve të tjera të nxënësve.

Lidhur me nxitjen e zhvillimit të një mjedisi shkollor përkrahës për të gjithë nxënësit, si edhe mbështetjes, bërjes sa më aktive të Këshillave Studentore/Qeverive të Nxënësve dhe organizimeve të tjera të nxënësve (në përputhje me nenin 36 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar 2023-2029), në datë 26 Shkurt MSHRF, zhvilloi konferencën "Rinia 2030 - një vit nga zbatimi i strategjisë së Rinisë". Gjatë kësaj konference, ishin prezent përfaqësues të institucioneve publike qendrore dhe vendore, organizata ndërkombëtare, OSHC-të dhe biznese të ndryshme. Konferenca u mbyll me workshope të drejtuara nga shoqëria civile, me angazhimin e vetë organizatave rinore dhe për të rinjtë, si dhe të rinjve të KVR-ve, anëtarëve të KKR-së dhe përfaqësues të qeverive të nxënësve. Ëorkshoptet u fokusuan në hapat e rradhës në zbatimin e SKR-së. Kjo konferencë u organizua me mbështetjen e BE-së dhe asistencës Teknike "Mbështetja e BE-së për Përfshirjen Sociale në Shqipëri" (EU 4 SI).

Në kuadër të Javës së Shoqërisë Civile më datë 31 Maj 2024, AKR ishte prezente në panelin e organizuar nga Partners Albania, i cili kishte në fokus përmirësimin e bashkëpunimit dhe koordinimit midis palëve të interesit. Aty u theksua se një ndër risitë dhe prioritetet e AKR-së është informimi i çdo të riu lidhur me mundësitë dhe aktivitetet rinore.

Me mbështetjen e MSHRF-së, në bashkëpunim me Dekanatin dhe stafin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe Qendrën e Shkollës së Drejtorëve, AKR organizoi në 15 Maj 2024, ceremoninë e shpërndarjes së certifikatave për 40 të rinjtë e talentuar të konkursit eseistik. Konkursi evidenton dhe promovon talentet e të rinjve.

Masa 1.1.5 është e realizuar.

Masa1.1.6 Rritet ndërgjegjësimi politik i të rinjve dhe në veçanti i vajzave dhe grave të reja nëpërmjet promovimit të edukimit të votuesve dhe nismave të tjera ndërgjegjësuere

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka në fokus të rinjtë, ku përfshihen dhe të rinjtë që i përkasin minoriteteve që jetojnë në Shqipëri, gratë dhe vajzat, etj. Në kuadër të realizimit të objektivave strategjikë, janë organizuar një seri sesionesh informuese, ndërgjegjësuere në qytete të ndryshme të Shqipërisë, me qëllim rritjen e informimit dhe pjesëmarrjes së tyre në proceset zgjedhore.

Gratë- Aktivitetet me gratë dhe vajzat synojnë të rigjallërojnë diskutimin rreth nivelit të përfshirjes së grave në pozicione vendimmarrëse në nivelet qendrore dhe lokale të qeverisjes, të rrisin ndërgjegjësimin dhe angazhimin e grupeve të interesit në përpjekjet për të siguruar përmirësimin e përfaqësimit të grave në vendimmarrje.

Janë zhvilluar takime me gratë dhe vajzat në qytetet Laç, Gjirokastrë, Berat, Pustec ku u përfshinë gra të minoritetit maqedonas, Finiq ku u përfshinë gra të minoritetit grek, dhe në Himarë.

Të rinjtë-Aktivitetet me të rinjtë synojnë të rrisin angazhimin e tyre në proceset zgjedhore dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje, gjithashtu përpjekjet tona për rritjen e ndërgjegjësimin të tyre për rëndësinë dhe vlerën që ka vota.

Janë organizuar rreth 15 takime me të rinjtë gjimnaze dhe në universitetet e Vlorës, Elbasanit, Shkodrës dhe Durrësit.

Masa 1.1.6 është e realizuar.

Masa 1.1.7 Promovohet dhe mbështetet e drejta e të rejave dhe të rinjve për vetë-shprehje në lidhje me orientimin e tyre seksual dhe/ose identitetin gjinor.

E drejta për shprehjen e orientimit seksual dhe identitetit gjinor është një çështje e rëndësishme që lidhet me të drejtat e njeriut dhe lirinë individuale, dhe mbështetja e saj është pjesë integrale e parimeve të barazisë dhe respektit për dinjitetin e çdo individi. MSHRF dhe AKR i ka kushtuar rëndësi trajtimit të saj, dhe në datat 13-17 Maj 2024 në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë, realizoi një fushatë përmes pesë videove sensibilizuese nga persona publikë dhe jo publikë, ku përgjatë 5 ditëve u përcollën në rrjete sociale mesazhe motivuese

Masa 1.1.7 është pjesërisht e realizuar

Masa 1.1.8 Rishikohet ligji “Për vullnetarizmin”, me qëllim fuqizimin e mundësive për vullnetarizmin e të rejave/rinjve

Gjatë vitit 2022 ka nisur proces konsultimi në nivel politik dhe teknik mes Ministrisë të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Agjencinë Kombëtare të Rinisë dhe rrjetit të organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në vlerësimin e zbatimit të ligjit nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin”, gjatë vitit 2020 e në vijim, me qëllim identifikimin dhe adresimin e të gjitha problematikave gjatë procesit të rishikimit ligjor.

Në përfundim të procesit të konsultimeve u vendos nisja e procesit të rishikimit tërësor të Ligjit nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin” dhe nga një grup i përbashkët pune, me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe rrjetit të organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në këtë proces, ka nisur puna, duke synuar angazhimin e të gjitha resurseve të disponueshme dhe të dhënave të mbledhura gjatë dy viteve të fundit për përgatitjen e një ligji efektiv, të qëndrueshëm dhe të gjithë pranuar, që do përmirësonte strukturën e vullnetarizmit dhe krijonte një mjedisi më mundësues për sektorin në Shqipëri. Grupi i përbashkët i punës ka vijuar punën gjatë vitit 2023 për përgatitjen e propozimeve ligjore me synimin që paketa e plotë të jetë e përgatitur, e konsultuar publikisht dhe paraqitur për miratim në Këshillin e Ministrave brenda vitit 2024.

Për Ligjin 45/2016 “Për vullnetarizmin” është mbajtur konferenca në Tiranë me praninë e të gjithë të interesuarve. Gjithashtu është zhvilluar një tur konsultimi publik në 12 bashki të vendit, në të cilën kanë marrë pjesë organizata jofitimprurëse, të rinj, antarë të KVR-së dhe KKR-së, përfaqësues nga institucionet e bashkive, punonjës rinorë, etj. Në turin konsultativ janë paraqitur rekomandimet, problematikat, ndryshimet dhe mosfunksionimet e ligjit. Janë diskutuar në detaje aspektet më problematike të Ligjit sipas vlerësimit të OSHC-ve lidhur me njohjen e punës vullnetare, kontraktimin dhe regjistrimin e vullnetarëve, kostot e sigurimit të tyre, si edhe mënyrën se si Ligji mund të kthehet në një instrument nxitës dhe mundësues për vullnetarizmin në Shqipëri.

Masa 1.1.8 është pjesërisht e realizuar


Masa 1.1.9 Në përputhje me ligjet dhe VKM për njohjen e përvojës së punës dhe mësimin informal dhe jo-formal njihen kompetencat e fituara nëpërmjet edukimit jo formal dhe punës rinore, bazuar në përcaktimet e profesioneve të punës së të rinjve nëpërmjet Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (AKAFPK) dhe klasifikimit të profesioneve (European Youth work Portfolio) 2022-2023

Masa 1.1.9 është masë pa raportim

Përmbledhje për Objektivin Specifik 1.1

NUMRI I MASAVE	TË PARAPORTUARA	TË RAPORTUARA
9	1	8
100%	11%	89%

NUMRI I MASAVE	PLOTËSISHT TË REALIZUARA	PJESËRISHT TË REALIZUARA	TË PAREALIZUARA
8	4	3	1
100%	50%	37.5%	12.5%



Objektivi specifik 1.2: Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm, duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave, Agjencinë Kombëtare të Rinisë.

Masa 1.2.1 Fuqizohen rolet zbatuese, koordinuese, monitoruese të AKR përmes fuqizimit të saj me burime financiare dhe njerëzore për të siguruar zbatimin e politikave sektoriale për rininë të pasqyruara në këtë strategji.

Në funksion të fuqizimit të AKR-së është rishikuar akti nënligjor i vitit 2020, që rregullon procesin e financimit nga buxheti i shtetit të projekteve rinore, Vendimi nr. 1141, datë 24.12.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë”, i cili shfuqizohet dhe është miratuar Vendimi nr. 566, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë”, i cili shfuqizon atë në fuqi.

Me qëllim forcimin e aftësive institucionale në përmbushjen e funksioneve dhe detyrave të tij në mënyrë më efektive, efikase dhe të qëndrueshme si dhe rritjen e ndikimit pozitiv dhe afatgjatë në shoqëri, përmes Urdhërit nr. 58 datë 18.04.2024 "Për miratimin e Strukturës së Agjencisë Kombëtare të Rinisë" të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë u miratua ristrukturimi i AKR-së si dhe rritja e numrit të punonjësve të saj në 30.

Masa 1.2.1 është e realizuar

Masa 1.2.2 Përmes AKR sigurohen fonde për rritjen e prezencës së Shqipërisë në proceset e politikëbërjes rinore si në nivel rajonal, evropian dhe global.

Shqipëria është anëtare e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (ZRBR), një mekanizëm institucional që funksionon në mënyrë të pavarur, i themeluar nga 6 (gjashtë) shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe që është një produkt konkret i Procesit të Berlinit : Shqipëria, Bosnja dhe

Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, që synon të promovojë frymën e bashkëpunimi mes të rinjve në rajon përmes programeve të shkëmbimit.

Në bazë të neneve 36 dhe 43 të ligjit nr. 116/2016 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Vendeve të Ballkanit Perëndimor për ngritjen e zyrës Rajonale për Bashkëpunimin Rinor, Statutit të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (ZRBR)”, përqindja kontribuuese e Shqipërisë tek buxheti i RYCO-s është 17.3% e cila përkthehet në vlerën 173,000 euro në vit, tarifë e cila paguhet çdo vit nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Rinisë në monedhën vendase.

AKR është partnere në Projektin “*Pjesëmarrja e të rinjve në demokracinë Digjitale*” i cili do të financohet nga Erasmus+ dhe synon të angazhojë dhe fuqizojë të rinjtë në Shqipëri, Mal të Zi, Serbi dhe Spanjë, veçanërisht ata nga komunitetet rurale dhe të margjinalizuara, në botën digjitale. Ky projekt synon të zhvillojë aftësitë digjitale të të rinjve duke rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e tyre digjitale, me një qasje të balancuar që thekson mbrojtjen dhe pjesëmarrjen në demokracinë digjitale. Organizatat partnere janë nga Serbia, Mal i Zi, Shqipëria, Spanja.

Më datat 19-21 Qershor përfaqësues të AKR morën pjesë në Youth Policy Lab on Green Agenda të organizuar nga Western Balkans Youth Lab, Regional Cooperation Council. Gjatë këtij aktiviteti u finalizuan rekomandime lidhur me politikat mjedisore dhe përfshirjen e të rinjve, gjithashtu u finalizua një draft-plan me masa për t'u zbatuar përgjatë vitit në vijim.

AKR me mbështetjen e MSHRF-së ka aplikuar në disa thirje për projekt-propozime nga donatorë të ndryshëm, si më poshtë vijojnë:

1. Projekti me titull: Future Ethically Effective Leadership (FEEL) - Lidërsip Etikisht Efektiv i së Ardhmes. Donator: *Bashkimi Europian – Programi Erasmus+*.
2. Projekti me titull: AI-Enhanced Critical Thinking (AICT) Exchange - Shkëmbimi i të menduarit kritik të përmirësuar me AI (AICT). Donator: *Bashkimi Europian – Programi Erasmus+*.
3. Projekti me titull: EmpowHer (Empoëer Her) – Fuqizo Atë (Femrën). Donator: *Bashkimi Europian – Programi Erasmus+*.
4. Projekti me titull: GreenHorizons: Nurturing Sustainable Minds - GreenHorizons: Ushqimi i mendjeve të qëndrueshme. Donator: *Bashkimi Europian – Programi Erasmus+*.
5. Projekti me titull: Health and Resilience: Mental Empoëerment for Neë Youth (HARMONY) - Shëndeti dhe qëndrueshmëria: Fuqizimi Mendor për të rinjtë. Donator: *Bashkimi Europian – Programi Interreg Europe*.
6. Projekti me titull: Empowering Governance in Cross-border Regions (GOV4CROSSBORDER) - Fuqizimi i Qeverisjes në Rajonet Ndërkufitare. Donator: *Bashkimi Europian – Programi Interreg Europe*.
7. Projekti me titull: Youth Empowered Heritage: Cross border Conservation and Innovation - Trashëgimia e fuqizuar nga të rinjtë: ruajtja dhe inovacioni ndërkufitar. Donator: *Bashkimi Europian – Programi IPA III CBC North Macedonia – Albania*.

Ka nisur puna në bashkëpunim me World Vision Albania për hartimin e një Manuali të përditësuar mbi Këshillat Vendorë Rinorë i cili ndër të tjerave do të ketë në fokus përfshirjen rinore në nivel lokal.

Masa 1.2.2 është e realizuar.

Masa 1.2.3 Bazuar në konceptin "Të rinjtë për të rinjtë" zhvillohen dhe aplikohen shërbime të informacionit për të rinjtë dhe rininë. Në këtë portal krijohet një platformë informimi dhe shërbimesh për të rinjtë dhe organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë që do të mbështesë formimin, punësimin, edukimin, mirëqenien, zhvillimin dhe aktivizimin e tyre.

Pavarësisht se masa parashikon aktivitete të lidhura me sistemin "Të Rinjtë për Të Rinjtë" i cili nuk është ndërtuar ende, AKPA në kuadër të iniciativave të saj ka kryer zhvillime të mëtejshme në këtë kontekst si:

- Është ndërtuar sistemi digjital për Qendrat e Formimit Profesional: Digjitalizim i gjithë procesit të brendshëm të punës. Certifikata digjitale;
- Portali i Ri i Punësimit dhe Aftësive: Ristrukturim i faqes puna.gov.al dhe dy faqe të reja aftesi.puna.gov.al dhe garanciarinore.puna.gov.al.
- Aplikim online për punë përmes portalit: Mundësia e aplikimit direkt në vendet e lira të shpallura nga punëkërkuessit e interesuar me kredencialet e e-Albania.
- Chat Portal dhe Call Center: Ndërtimi i një chati në portal që lejon komunikimin në kohë reale me punëkërkuessit. Punonjësit e zyrave do të kenë mundësi për të kontaktuar me qytetarët dhe bizneset për çdo shërbim apo informim me anë të Call Center.

Masa 1.2.3 është pjesërisht e realizuar

Masa 1.2.4 Fuqizohen kapacitetet e politikë-bërësve dhe nëpunësve civilë në fushën e rinisë dhe zbatimin e politikave rinore, bazuar në konceptin e shërbimeve miqësore dhe të pranueshme nga të rejtat dhe të rinjtë dhe forcohet bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e politikave rinore

Lidhur me rritjen e kapaciteteve të nëpunësve civilë për të siguruar ofrim shërbimesh të përshtatshme dhe miqësore për rininë në bashkëpunim me organizatat rinore dhe aktorë të tjerë me peshë në këtë fushë, më datë 7 Prill 2024, organizata “New Bridges” zhvilloi në bashkinë Dimal workshopin 2 ditor me titull "Zbatimi i planeve dhe politikave rinore në nivel vendor" ku morën pjesë punonjësit rinorë, anëtarët e KVR-së, anëtarët e Këshillit Bashkiak dhe të rinjtë e grupit rinor. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të projektit "Pjesëmarrja e të rinjve në vendimarrje modelon të ardhmen" të financuar nga AKR.

Masa 1.2.4 është pjesërisht e realizuar

Përmbledhje për Objektivin Specifik 1.2



Objektivi specifik 1.3: Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm, duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë

Masa 1.3.1 Krijohen baza të dhënash statistikore dhe studimore për rininë në Shqipëri, përmes forcimit të kërkimit shkencor rreth rinisë, si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe fuqizohet studimi i rinisë si fushë akademike dhe shkencore.

MSHRF ka kontribuar në realizimin e ushtrimeve për të përcaktuar indikatorët që konsiderohen me rëndësi për Shqipërinë në fushën e rinisë, për t'u përfshirë në modulet e anketimit MICS që është në proces realizimi nga UNICEF në bashkëpunim me INSTAT në Shqipëri. MICS (Multiple Indicator Cluster Surveys) është një platformë e përbërë nga një sërë anketash të ndërmarrë nga UNICEF. Këto anketa mbledhin të dhëna mbi shumë tregues të lidhur me mirëqenien e fëmijëve dhe grave. Të dhënat e MICS janë gjerësisht përdorura për hartimin e politikave, planifikimin e programeve dhe monitorimin e progresit drejt qëllimeve ndërkombëtare për zhvillim, duke përfshirë këtu dhe lidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs). Takimi i radhës lidhur me MICS është zhvilluar në Qershor 2024, në të cilin u diskutua lidhur me indikatorët e vlerësuar deri në këtë fazë të MICS-së.

Gjatë periudhës raportuese, INSTAT është duke zhvilluar Censin e Popullsisë dhe Banesave 2023, i cili do të sigurojë të dhëna për të rinjtë sipas karakteristikave socio-demografike, arsimit, punësimit, aftësive të kufizuara, lindjeve të gjalla, migracionit etj. CENS 2023 mundëson zhvillimin e analizave të thelluara dhe kërkimin shkencor në fusha të ndryshme, duke përfshirë edhe të rinjtë.

Në datë 24 Qershor 2024 u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit mes AKR-së dhe INSTAT, e cila ka si objekt bashkëpunimin për kërkimin shkencor për rininë, realizimin e trajnimeve të stafit si dhe studimeve rinore, etj. Me anë të këtij bashkëpunimi, dy institucionet vendosin në dispozicion njëri-tjetrit të gjitha burimet njerëzore dhe materiale për përmbushjen e qëllimeve të përbashkëta.

Masa 1.3.1 është pjesërisht e realizuar.

Masa 1.3.2 Politikat Zhvillimore rinore ndërtohen mbi analiza faktike dhe dokumentare

Masa është e përcaktuar për shkak të vështirësive në gjetjen e donatorëve për të mbuluar studimet

Masa 1.3.3 Në përputhje me Ligjin për Rininë dhe aktin nënligjor të dalë në bazë dhe për zbatim të tij, zhvillohet baza e të dhënave për organizatat rinore dhe për rininë, duke përfutur edhe nga proceset e digjitalizimit të shërbimeve publike.

Nëpërmjet vijimit të takimeve, të komunikimeve dhe monitorimit të vazhdueshëm të ecurisë së procedurave lidhur me krijimin e Regjistrimit Elektronik për Rininë (RER) dhe Implementimin e Sistemit Elektronik për Financimin e Projekteve të Dedikuara për të Rinjtë, është diskutuar teknikisht mundësia e bashkimit në një sistem të vetëm të Regjistrimit Elektronik për Rininë dhe Implementimit të Sistemit Elektronik për Financimin e Projekteve të Dedikuara për Rininë, me qëllim vijimin e procedurës së prokurimit në një të vetme e cila do të mundësonte përdorimin më


me efikasitet të fondeve buxhetore, pa cënuar funksionalitetin e tyre. MSHRF dhe AKR dakordësuan bashkimin e dy sistemeve dhe përcaktuan përfaqësuesit në grupin e punës për hartimin e termave të referencës për llogaritjen e fondit limit dhe hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e unifikuar të prokurimit.

Masa 1.3.3 është pjesërisht e realizuar

Përmbledhje për Objektivin Specifik 1.3

NUMRI I MASAVE	TË PARAPORTUARA	TË RAPORTUARA
3	0	3
100%	0%	100%

NUMRI I MASAVE	PLOTËSISHT TË REALIZUARA	PJESËRISHT TË REALIZUARA	TË PAREALIZUARA
3	0	2	1
100%	0%	66%	34%



QËLLIMI POLITIK II: Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity)

Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.


Qëllimi i Politikave II, ka në përmbajtje të tij 3 Objektiva Specifikë dhe 13 Masa. Ky qëllim politik zbërthehet në masa që lidhen me punësimin e të rinjve, aftësimin e tyre në fushën e TIK dhe digjitalizimit, këshillimin e karrierës, zhvillimin e programeve sportive, artit, zejeve dhe programe të tjera jashtë-kurrikulare, mbështetjen e sipërmarrjes dhe start-up.

Përmbledhje për Qëllimin Politik 2

NUMRI I MASAVE	TË PARAPORTUARA	TË RAPORTUARA
13	1	12
100%	8%	92%

NUMRI I MASAVE	PLOTËSISHT TË REALIZUARA	PJESËRISHT TË REALIZUARA	TË PAREALIZUARA
12	6	5	1
100%	50%	33%	17%

Qëllimi Politik II



Më poshtë paraqitet një panoramë e detajuar mbi hapat konkretë të ndërmarrë gjatë periudhës raportuese, me qëllim realizimin e masave të parashikuara për secilin objektiv specifik.

Objektivi specifik 2.1: Të rinjtë janë të aftësuar, të mirinformuar në lidhje me mundësitë për punësim dhe në gjendje të bëjnë zgjedhje autonome kur i bashkohen popullsisë ekonomiksht aktive.

Masa 2.1.1 Bashkërendohet Politika Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive me masat e propozuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë, duke rritur nivelin e punësueshmërisë rinore, punësimin dhe sipërmarrjen e të rinjve përmes angazhimit dhe ndërveprimit të këshillave vendorë rinorë, ndërmarrjeve dhe startup-eve.

Në kuadër të forcimit, rritjes dhe zhvillimit më tej shërbimet e pranueshme dhe të orientuara nga të rinjtë në lidhje me udhëzimin për karrierë dhe punësim, mentorim dhe edukim të të rinjve në marrjen e aftësive për punësim, janë zhvilluar aktivitete specifike për të nxitur pjesëmarrjen në tregun e punës së të rinjve që janë larg qendrave të mëdha të punësimit dhe që nuk përfshihen në aktivitete punësimi. Në kuadër të Thirrjes Nr. III për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, Organizata “Be the Change” ka zbatuar projektin me titull “Të Orientuar Drejt Suksesit” i cili synon identifikimin e nevojave dhe mundësive për zhvillim. Ky projekt do të të impaktojë 1000 të rinj në aktivitete trajnimesh, tryeza të rumbullakëta dhe sesione informuese në Bashkitë Tiranë, Vlorë, Shkodër, Lezhë dhe Durrës. Gjatë muajve Shkurt, Mars, Prill janë zhvilluar 5 workshop-e me qëllim.

Në kuadër të Thirrjes Nr. III për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, Qendra “Synergy” ka zbatuar projektin me titull “Ferma Edukative” i cili synon trajnimin e 120 të rinjve në Bashkitë Tiranë dhe Durrës. Gjatë periudhës Shkurt - Mars 2024 janë zhvilluar trajnime periodike lidhur me aftësimin në agroturizëm dhe zhvillimin e turizmit rural.

Shoqata e Bashkuar Agro-Mjedisore (Agri-En), e cila ka zhvilluar projektin me titull “Punësimi i të Rinjve në Zonat Malore është Sfidë dhe Mundësi” që përfshiu e 50 të rinj të përzgjedhur me thirrje të hapur me qëllim trajnimin e tyre në bashkitë Librazhd, Prrenjas dhe Elbasan. Nëpërmjet këtij projekti në periudhën Janar - Qershor 2024 janë realizuar trajnime të vazhdueshme me qëllim integrimin e të rinjve në komunitet, motivimin dhe rritjen e kapaciteteve të tyre në punësim.

Qendra “Action for Albania” zbatoi projektin “Action for Youth” që synoi informimin dhe orientimin e rreth 300 të rinjve për nevojat dhe mundësitë e tregut të punës si edhe trajnimin e 60 të rinjve “Programi i Sipërmarrjes” Ky projekt u zbatua në bashkitë Peshkopi, Burrel dhe Bulqizë.

➤ **Programi Kombëtar i Praktikave të Punës**

Gjatë periudhës raportuese ka filluar procesi i Thirrjes IX të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës.

Gjatë janarit të vitit 2024 u përmyll faza e fundit dhe më e rëndësishme e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës Thirrja VIII, punësimi i 162 praktikantëve me kontratë 1-vjeçare nga institucionet përkatëse ku ata kanë kryer praktikën. Praktikantët e punës u mirëpritën nga 17 institucione të administratës shtetërore, nga të cilat 94 institucione varësie, 51 njësi të Vetëqeverisjes Vendorë, 16 Institucione të Pavarura, 25 Shoqëri Tregtare dhe 19 Organizata Jofitimprurëse.

Gjatë qershorit 2024 nisi puna përgatitore për hapjen e thirrjes së nëntë të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, (Metodologjia dhe Plani i Veprimit në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, Thirrja e Nëntë).

Gjatë periudhës raportuese, është miratuar urdhri për shpalljen e thirrjes së nëntë në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës. Thirrja IX do ofrojë mbi 1200 pozicione praktike pune.

➤ Programi i Kodimit

Një nga programet e krijuara me qëllim rritjen e nivelit të punësueshmërisë rinore dhe punësimin dhe sipërmarrjen e të rinjve është dhe Programi i Kodimit, i cili është lancuar më datë 23 janar 2023 nën koordinim të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijet me Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe implementohet nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Punësimin dhe Aftësive.

Ofruesit e kurseve profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit të kualifikuar deri më tani janë: “Albanian ICT Academy”, “BetaPlan Coding Bootcamps”, “Holberton School”, “SDA by Protik”, “IkubInfo Academy” dhe “Communication Progress”. Aplikimi online për kurset profesionale kryhet me anë të portalit e-Albania, nëpërmjet shërbimit “Aplikim për Kursin e Formimit Profesional me Mbështetje Financiare” dhe më pas kjo kërkesë ndiqet dhe administrohet nga AKPA.

- Programi që prej 1 shkurtit 2024 ka hapur shërbimet në e-albania për aplikime nga të rinjtë. Në program janë 8 akademi të kualifikuara dhe 36 kurse në total për ofrimin e kurseve në Programin e Kodimit. Nga data 1 shkurt 2024, deri më datë 24 prill 2024, në e-albania ka 841 aplikime për programin, nga të cilët 312 individë kanë filluar kurset.
- Më datë 22 maj u organizua takimi online me akademitë e kodimit të kualifikuara për ofrimin e Programit të Kodimit, i drejtuar nga AKPA dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ku Akademitë u njoftuan për pezullimin e programit dhe mbylljen e shërbimit të aplikimit në e-Albania deri më shtator 2024.

Në kuadër të projektit të Kodimit në Shkolla, Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë pajisjen e shkollave të arsimit parauniversitar publik në Shqipëri me laboratorë Smart. Infrastruktura e laboratorëve Smart është dizenuar në mënyrë që të mbështesë mësimdhënien gjatë orarit mësimor për të gjitha klasat e arsimit parauniversitar dhe gjithashtu përdorimin nga nxënësit për programet jashtëshkollore.

- Kurrikula e klasës së tretë - Realizuar dhe përshtatur në shqip kurrikula e TIK për klasën e III nga Grupi Ndërinstitucional i Punës, e cila është miratuar nga MAS. Realizuar versioni në anglisht i manualit të mësuesit dhe librit të punës së nxënësit të TIK për klasën e III nga Grupi Ndërinstitucional i Punës. Në datat 17-21 qershor është zhvilluar trajnimi i mësuesve trajnerë për mësimdhënien e lëndës së TIK në klasën e tretë, i cili ka përfunduar me sukses me pjesëmarrjen e plotë të 25 mësuesve trajnerë.
- Realizuar të gjitha fazat e trajnimit të mësuesve për kurrikulat e klasave të para dhe të dyta përgjatë vitit arsimor 2023-2024.
- Diskutuar draft-plani i punës për përditësimin e kurrikulave në një mbledhje të përbashkët me MAS, ku u dakordësua rishikimi i përsheptuar i kurrikulave 4-12 në periudhën 2024-

2028, si dhe u vendosën hapat e parë për fillimin e punës dhe realizimin e analizave të nevojshme të gjendjes aktuale.

- Realizuar takimi me AADF me qëllim diskutimin e planit të punës dhe mbështetjes së AADF për këtë plan.
- Realizuar takimi me Grupin Ndërinstitucional të Punës për përditësimin e kurrikulave të këtyre klasave për vitin arsimor 2024-2025, realizuar ndarja e detyrave për fillimin e punës. Janë dërguar materialet fillestare për fillimin e punës. Në proces rishikimi i materialeve nga GNP.
- Gjatë qershorit 2024 janë realizuar seanca të trajnimit të mësuesve që mësojnë lëndën e kodimit në shkolla me ekspert anglez, që ekspertizën i përçoi tek mësuesit shqiptar me mbështetjen e AADF-së duke ndjekur vizionin e qeverisë shqiptare, për të tretin vit radhazi, tashmë edhe për klasën e tretë.
- Më 21 maj Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët takoi nxënësit e shkollës jopublike “Pavarësia” një ndër 43 shkollat jopublike që janë bashkuar në Programin e Kodimit me mbështetjen e AADF-së, për të pajisur fëmijët me aftësi digjitale që në moshë të vogël. Në të njëjtën kohë nxënësit u certifikuan për arritjet e tyre në fushën digjitale.

Në vitin arsimor 2023-2024, Qeveria Shqiptare në bashkëpunim me AADF, në bazë të projektit ElementIt, ka realizuar ndërtimin e 216 smartlab-eve në 200 shkolla të arsimit parauniversitar, duke ju shtuar 100 laboratorëve ekzistues. Mbi 35 mijë fëmijë në arsimin fillor kanë mundësinë të mësojnë përmes platformave interaktive, ndërkohë që Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit është integruar në kurrikulën e re shkollore.

Diskutuar draft-plani i punës për përditësimin e kurrikulave në një mbledhje të përbashkët me MAS, ku u dakordësua rishikimi i përsheptuar i kurrikulave 4-12 në periudhën 2024-2028, si dhe u vendosën hapat e parë për fillimin e punës dhe realizimin e analizave të nevojshme të gjendjes aktuale.

- Realizuar takimi me AADF me qëllim diskutimin e planit të punës dhe mbështetjes së AADF për këtë plan.
- Realizuar takimi me Grupin Ndërinstitucional të Punës për përditësimin e kurrikulave të këtyre klasave për vitin arsimor 2024-2025, realizuar ndarja e detyrave për fillimin e punës. Në proces përgatitja e materialeve nga GNP.

Në vitet në vijim synohet ndërtimi i 644 laboratorëve në 605 shkolla me mbështetjen e WBIF dhe CEB.

Synimi afatgjatë i këtij projekti është pajisja e të gjitha shkollave publike të arsimit parauniversitar me laboratorë Smart.

- Në kuadër të forcimit, rritjes dhe zhvillimit më tej shërbimet e pranueshme dhe të orientuara nga të rinjtë në lidhje me udhëzimin për karrierë dhe punësim, mentorim dhe

edukim të të rinjve në marrjen e aftësive për punësim, janë zhvilluar aktivitete specifike për të nxitur pjesëmarrjen në tregun e punës së të rinjve që janë larg qendrave të mëdha të punësimit dhe që nuk përfshihen në aktivitete punësimi. Në kuadër të Thirrjes Nr. III për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, Organizata “Be the Change” ka zbatuar projektin me titull “Të Orientuar Drejt Suksesit” i cili synon identifikimin e nevojave dhe mundësive për zhvillim. Ky projekt do të të impaktojë 1000 të rinj në aktivitete trajnimesh, tryeza të rrumbullakëta dhe sesione informuese në Bashkitë Tiranë, Vlorë, Shkodër, Lezhë dhe Durrës. Gjatë muajve Shkurt, Mars, Prill janë zhvilluar 5 Workshop-e me qëllim.

Në kuadër të Thirrjes Nr. III për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, Qendra “Synergy” ka zbatuar projektin me titull “Ferma Edukative” i cili synon trajnimin e 120 të rinjve në Bashkitë Tiranë dhe Durrës. Gjatë periudhës Shkurt - Mars 2024 janë zhvilluar trajnime periodike lidhur me aftësimin në agroturizëm dhe zhvillimin e turizmit rural.

Shoqata e Bashkuar Agro-Mjedisore (Agri-En), e cila ka zhvilluar projektin me titull “Punësimi i të Rinjve në Zonat Malore është Sfidë dhe Mundësi” që përfshiu e 50 të rinj të përzgjedhur me thirrje të hapur me qëllim trajnimin e tyre në bashkitë Librazhd, Prrenjas dhe Elbasan. Nëpërmjet këtij projekti në periudhën Janar - Qershor 2024 janë realizuar trajnime të vazhdueshme me qëllim integrimin e të rinjve në komunitet, motivimin dhe rritjen e kapaciteteve të tyre në punësim.

Qendra “Action for Albania” zbatoi projektin “Action for Youth” që synoi informimin dhe orientimin e rreth 300 të rinjve për nevojat dhe mundësitë e tregut të punës si edhe trajnimin e 60 të rinjve “Programi i Sipërmarrjes” Ky projekt u zbatua në bashkitë Peshkopi, Burrel dhe Bulqizë.

➤ **Zhvillime në kuadër të zbatimit të Garancisë Rinore**

Në përputhje me angazhimet e vendeve të Ballkanit Perëndimor për të siguruar përfshirjen e qëndrueshme në tregun e punës të të rinjve të moshave 15-29 vjeç, Shqipëria ka përgatitur dhe miratuar Planin e Zbatimit të Garancisë Rinore (YGIP) 2023-2024. Siç parashikohet në Rekomandimin e Këshillit Evropian për Një Urë drejt Punësimit – Përforcimi i Garancisë Rinore (2020), Garancia Rinore siguron akses universal për të gjithë individët e rinj nën 30 vjeç që nuk janë të përfshirë në arsim, aftësim apo punësim (NEET), koherencë dhe koordinim të politikave – bazuar mbi partneritete të ndryshme - me qëllim "garantimin" e një oferte cilësore brenda katër muajve, monitorimin e vazhdueshëm dhe përdorimin efektiv të burimeve financiare vendase dhe të tjera. Projekti “BE-ja për rininë” synon të përmirësojë punësueshmërinë e të rinjve dhe të rejave, që nuk janë në punësim, arsim apo formim, nëpërmjet mbështetjes për zbatimin e skemës së Garancisë Rinore në Shqipëri.

Lidhur me 6-mujorin e parë të 2024, ka filluar pilotimi dhe aftësimi dhe forcimi i strukturave të qeverisjes së Garancisë Rinore në nivel qendror dhe vendor, duke siguruar angazhimin e të rinjve dhe partnerëve socialë. Mbështetja e zhvillimit të një modeli për Rrjetet e Partnerëve Vendorë (kontaktimi dhe përgatitja). Ngritja dhe aftësimi i Rrjeteve të Partnerëve Vendorë në bashkitë e Tiranës, Vlorës dhe Shkodrës. Mbështetja e krijimit të partneriteteve të Garancisë Rinore në terren, nëpërmjet mënyrave novatore të angazhimit dhe bashkë-konceptimit. Ofrimi i asistencës teknike për të përmirësuar disponueshmërinë e informacioneve periodike dhe gjithëpërfshirëse mbi NEET

në Shqipëri. Ofrimi i komunikimit efikas dhe promovimi i skemës së Garancisë Rinore në të tre bashkitë. Faza e pilotimit po zbatohet nga AKPA, në bashkëpunim me UNICEF/UNDP.

➤ **Panair edukimi, trajnimi dhe punësimi në çdo qark;**

Zhvillohen panire punësimi dhe edukimi për të rinjtë në të gjithë Shqipërinë. Gjatë periudhës së raportimit është zhvilluar Panairi i Edukimit, Trajnimit dhe Punësimit në Berat, Fier, Gjirokastrë, Dibër, Elbasan.

Këto panire kanë si synim informimin e të rinjve në këto drejtime dhe prezantimin e mundësive ekzistuese reale për të lehtësuar kalimin e të rinjve nga shkolla në tregun e punës, por edhe për zhvillimin e tyre personal, akademik dhe profesional.

Të rinjtë janë njohur me mundësi, shërbime dhe oferta lokale me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes aktive në qytetet dhe zonat respektuese banuese, por njëkohësisht janë njohur edhe me mundësi kombëtare, në mënyrë që edhe ata të rinj që studiojnë dhe janë përkohësisht banues në qytete apo zona të tjera, të kenë mundësi të integrohen në tregun e punës dhe të kenë të ardhurat e tyre.

Më konkretisht paniret janë realizuar në bashkëpunim me bashkitë, si dhe me zyrën e punës dhe aftësimin. Nga ana tjetër, kemi pasur përfaqësi të ministrive të linjës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (agjencitë për zonat e mbrojtura), Ministria e Mbrojtjes me anë të Forcave të Armatosura Shqiptare, të cilët kanë promovuar skemat për të rinjtë që duan t'i bashkohen forcave të armatosura.

Gjithashtu kemi pasur përfaqësi nga shoqata e bankave dhe bankat të cilat kanë degë në qytetet ku janë zhvilluar paniret, universitetet publike dhe private që kanë prezantuar bursat në dispozicion të studentëve. Nga bizneset sipas qyteteve kemi pasur prezentë dhe bizneset lokale në fushat e artizanatit, bujqësore, hoteleri turizëm, dhe industria ushqimore.

Në panair kemi informuar të rinjtë lidhur me programet në dispozicion të tyre, si programi kombëtar i praktikave të punës, programi i kodimit për të rinjtë, dhe programet periodike të trajnimit apo punësimit, siç është edhe lançimi i skemës së garancisë rinore.

Përgjatë panireve, të rinjtë janë njohur edhe me projektet rinore që po zbatohen në qarqet përkatëse nga organizatat rinore dhe për të rinjtë me mbështetjen financiare nga Agjencia Kombëtare e Rinisë, mundësuar kjo nga thirrja e dytë dhe e tretë për projekt-propozime për projekte rinore.

5 Janar 2024 - Takim me Sektorët Privat mbi Aftësitë në Tregun e Punës Diskutim mbi sfidat dhe nevojat për aftësi në Tregun e Punës; prezantimi i programeve të Nxitjes së Punësimit nga AKPA.

Gjatë periudhës janar- qershor 2024 rezultoi se 642 pu.pa kanë ndjekur kursin aftësi digjitale prej të cilëve 59% i përkisnin grupmoshës 15-29 vjeç.

Gjithashtu, në QFPP Fier u zhvillua kursi Start Smart i cili u ndoq nga 40 punëkërkues të papunë (pu.pa) 13% e të cilëve ishin të rinj.

Pu.Pa pjesëmarrës në kursin Aftësi Digjitale

QFPP-TË	TOTAL	15-29 VJEC	%
QFPP DURRËS	166	96	58%
QFPP ELBASAN	7	3	43%
QFPP FIER	113	58	51%
QFPP GJIROKASTËR	26	21	81%
QFPP KORÇË	82	50	61%
QFPP LËVIZËSE	79	43	54%
QFPP NR. I	27	14	52%
QFPP NR. IV	59	37	63%
QFPP SHKODËR	83	55	66%
TOTAL	642	377	59%

Pu.Pa pjesëmarrës në kursin Start Smart

QFPP-TË	TOTAL	15-29 VJEC	%
QFPP FIER	40	5	13%
TOTAL	40	5	13%

Hartimi dhe Zbatimi i programit të kodimit si një program në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës.

Gjatë periudhës janar- qershor 2024, ky program është ndjekur nga 494 pjesëmarrës (461 punëkërkues dhe 33 punëkërkues të papunë) prej të cilëve 396 pjesëmarrës ose 80% e totalit ishin 15-29 vjeç.

Pu.pa dhe punëkërkues 15-29 vjeç pjesëmarrës në Programin e Kodimit janar- qershor 2024

LLOJI I PROGRAMIT	JANAR - QERSHOR 2024		
	TOTAL	15-29 VJEC	%
PUNËKËRKUES	461	368	80%
PUNËKËRKUES TË PAPUNË	33	28	85%
.NET	14	12	86%
Analist biznesi dhe trajnues i sistemit IMPRO ERP	14	14	100%
BAZAT E SHKENCËS KOMPJUTERIKE	1	1	100%
CYBER SECURITY	49	38	78%
DATA SCIENCE	10	6	60%
DevOps	14	9	64%
FullStack Development	29	21	72%
Full-Stack Web Development	6	6	100%
Inteligjenca Artificiale	1	1	100%
Java	126	104	83%
Javascript	51	44	86%
Javascript Fullstack	14	11	79%
Oracle	18	18	100%
Programimin Front-End	18	17	94%
Programming & Data Processing	8	6	75%
Python	30	25	83%
Python Fullstack	12	10	83%
Software Development	25	20	80%
Software tester	18	9	50%
System Administrator	10	5	50%
Web Development	2	0	0%
Web Development, Frontend Programmer	11	6	55%
Web Development, Java Backend Programmer	4	4	100%
Zhvillues dhe Implementues i Sistemit IMPRO ERP	9	9	100%
TOTAL	494	396	80%

Pu.pa 15-29 vjeç pjesëmarrës në PNP

LLOJI I PROGRAMIT	JANAR - QERSHOR 2024		
	TOTAL	15 - 29 VJEC	%
V.K.M 17 (PROGRAMI 1 PUNËSIMIT)	232	101	44%
V.K.M 17 (PROGRAMI 2 FORMIMI NËPËRMJET PUNËS)	205	109	53%
V.K.M 17 (PROGRAMI 3 PRAKTIKAT E PUNËS)	519	504	97%
V.K.M 535 (PUNËT NË KOMUNITET)	831	62	7%
TOTAL	1,787	776	43%

Masa 2.1.1 është pjesërisht e realizuar.

Masa 2.1.2 Nxitet dhe forcohet punësimi rinor në fushën e TIK dhe digjitalizimit përmes zhvillimit të programeve të aftësisë në kodim, TIK dhe digjitalizim, bazuar në studimet e tregut dhe zhvillimit të punësimi në këtë fushë si në Shqipëri dhe me gjerë.

Programi i kodimit për të rinjtë që prej 1 shkurtit ka hapur shërbimet në e-albania për aplikime nga të rinjtë. Në program janë 8 akademi të kualifikuara dhe 36 kurse në total për ofrimin e kurseve në Programin e Kodimit. Nga data 1 shkurt, deri më datë 24 prill, në e-albania ka 841 aplikime për programin, nga të cilët 312 individë kanë filluar kurset.

18 Janar 2024 - Suksesi i Koduesve të Programit të Kodimit - 33 kodues të rinj, përfshirë 11 nga Programi i Machine Learning, janë integruar në Tregun e Punës.

. Npërmjet thirrjes III janë realizuar disa aktivitete dhe trajnime lidhur me aftësitë digjitale.

Organizata: “Shoqata e Bashkuar Agro-Mjedisore (Agri-En)” me projektin “*Punësimi i të rinjve në zonat malore është sfidë dhe mundësi*”. Qëllimi i projektit: Integrimi i të rinjve në komunitetet, motivimi dhe rritja e kapacitetit të tyre për punësim i cili synon përfshirjen e 50 të rinjve të përzgjedhur me thirrje të hapur me qëllim trajnimin e tyre në bashkitë Librazhd, Prrenjas dhe Elbasan. Shtrirja e projektit: Bashkia Librazhd (Njësia Administrative Lunik), Bashkia Prrenjas (Njësia Administrative Stravaj), Bashkia Elbasan (Njësia administrative Labinot Mal). Npërmjet këtij projekti në periudhën janar-qershor 2024 janë realizuar trajnimet me titull “Teknologjia e informacionit rrjet komunikimi i grupit” me qëllim rritjen e njohurive të reja për teknologjinë dhe shërbimet në fermë.

Npërmjet thirrjes publike Nr.III janë realizuar aktivitete të ndryshme nga organizatat fituese të që kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e synimit për nxitjen e punëve të denja dhe ndërlidhjen e të rinjve me tregun e punës, të cilat janë:

Organizata Qendra për Media dhe Çështjet Shoqërore me projektin “*GenZ*”. Synimi i projektit është krijimi i një platforme novatore me qëllim që të aktivizojë, të përfshijë dhe të mbështesë të rinjtë për të zhvilluar mendimin kritik duke diskutuar pro dhe kundër për tema që prekin ata dhe shoqërinë shqiptare. “*GenZ*” synon të krijojë një kulturë të debatit dhe të ndikimit pozitiv të të

rinjve në proceset vendimmarrëse, duke kontribuar në formimin e një shoqërie më të përgjegjshme dhe të përfshirë. Shtrirja e projektit: Vorë, Kamëz & Tiranë.

Organizata: “Qendra Synergy” me projektin “*Ferma educative*”. Qëllimi i Projektit është të sigurojë përgatitjen dhe aftësimin e të rinjve për të kontribuar në zhvillimin e turizmit rural dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve agroturistike në fermën agroturistike dhe për të promovuar turizmin rural në komunitetin lokal dhe në tregun e gjerë. Të rinjtë do të sjellin ide të reja, inovacion dhe energji të freskëta në fushën e bujqësisë dhe turizmit rural. Shtrirja e Projektit: Tiranë dhe Durrës.

Organizata: “Be the Change” me projektin “*Të orientuar drejt suksesit*”. Qëllimi i projektit është rritja e kapacitetit të të rinjve për edukim dhe orientim në karrierë dhe për rrjedhojë dhe rritja e nivelit të tyre të punësimit. Shtrirja e projektit: Tiranë, Vlorë, Shkodër, Lezhë dhe Durrës.

Organizata: “Qendra Youth Rise” me projektin “*Unlock your technological skills*”. Qëllimi i projekti është krijimi i një mjedisi mbështetës për të rinjtë duke promovuar aftësitë inovative, digjitale dhe sipërmarrëse.

Organizata: “Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” (CRCA/ECPAT Shqipëri) me projektin “*Një ndalesë për shërbime rinore të integruara*”. Qëllimi i projektit: Qeverisje lokale efektive dhe gjithëpërfshirëse që garanton mbështetjen, fuqizimin dhe pjesëmarrjen në jetën sociale dhe ekonomike të të rinjve në Bashkitë Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll. Shtrirja e projektit: Bashkitë Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll.

Në të njëjtën linjë, thirrja e 4 për projekt-propozime të dedikuara për rininë e shpallur nga Agjencia Kombëtare e Rinisë për organizatat rinore dhe për të rinjtë fokusohet në 3 prioritet kryesore që lidhen ngushtë me SKR 22022-2029. Prioritetet e thirrjes janë përcaktuar nëpërmjet një procesi konsultues dhe gjithëpërfshirës dhe ndër të tjera, thirrja e katërt ka synuar të adresojë një fushë përparësive si: Nxitja e punëve të denja dhe ndërlidhjes së të rinjve me tregun e punës.

Masa 2.1.2 është masë e realizuar.

Masa 2.1.3 Pranë institucioneve arsimore dhe aftësuese zhvillohen shërbime inovative dhe digjitale të këshillimit për punësim dhe orientim në karrierë miqësore për të rinjtë dhe në respektim të shanseve të drejta dhe të barabarta për të arritur potencialin e plotë rinor.

Organizata: “Be the Change” ka zbatuar projektin me titull “Të orientuar drejt suksesit”.

Me qëllim rritjen e kaceteteve të të rinjve për edukim dhe orientim në karrierë dhe për rrjedhojë dhe rritjen e nivelit të tyre të punësimit. Ky projekt është shtrirë në Bashkitë Tiranë, Vlorë, Shkodër, Lezhë dhe Durrës.

Organizata: “Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” (CRCA/ECPAT Shqipëri) Nëpërmjet projektit me titull “Një ndalesë për shërbime rinore të integruara” ka zhvilluar një sërë aktivitësh me qëllim gjithëpërfshirjen, mbështetjen, fuqizimin dhe pjesëmarrjen në jetën sociale dhe ekonomike të të rinjve në Bashkitë Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll.

Organizata: “Action for Albania” me projektin “*Action for youth*”: Qëllimi i përgjithshëm i projektit është ngritja e kapaciteteve të të rinjve për aftësimin profesional si dhe mentorimi dhe mbështetja e ideve inovatore të sipërmarrjes (startups) si aktivitet kritik për ndërlidhjen e të rinjve

me tregun e punës, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të bashkive si dhe rritjen e mirëqenies së komunitetit. Shtrirja e Projektit: Peshkopi, Burrel & Bulqizë.

Organizata: “Qendra “Konkret” me projektin “*Dedicated, determined and driven youth of Elbasan*”. Qëllimi i projektit: Edukimi i të rinjve me në fokus vajzat rreth fenomeneve të ndryshme të krimeve kibernetike, risitë e fushës dhe dinamikën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe orientimin e tyre drejt profileve të punës së sigurisë së informacionit dhe profile të ngjashme me të. Shtrirja e projektit: Bashkia Elbasan, Bashkia Librazhd dhe Bashkia Gramsh.

- 23 Janar 2024 - Takim mbi Përfshirjen Sociale të Të Rinjve - Diskutim mbi mbështetje për sipërmarrësit e rinj dhe mundësitë e përfshirjes në jetën socio-ekonomike.

Kjo temë bëri bashkë në një takim të organizuar nga “Partners Albania for development and change”, përfaqësues të institucioneve qeveritare, OSHC-ve, biznesit, të rinj dhe të reja, të cilët ndanë eksperiencat dhe diskutuan mbi mundësitë që të rinjtë kanë për përfshirjen në jetën politike e socio-ekonomike të vendit. Përmes programeve që synojnë mbështetjen e sipërmarrësve të rinj, në sektorët prioritarë të ekonomisë së vendit, programit të dedikuar të Garancisë Rinore, përfaqësues të AKPA ndanë programet aktive të Tregut të Punës që institucioni ofron në mbështetje të të rinjve.

➤ **Udhëzuesi i Orientimit në Karrierë**

Është përgatitur “Materiali informues për plotësimin e formularëve të orientimit të nxënësit të klasës së 9-të për arsimin e mesëm të lartë” në bashkëpunim me specialistët e SMIP.

Gjatë muajit maj 2024, janë zhvilluar veprimtaritë trajnuese në lidhje me materialin informues për plotësimin e formularëve të orientimit të nxënësit të klasës së 9-të për arsimin e mesëm të lartë. Janë trajnuar 56 specialistë të caktuar si koordinatorë të orientimit të karrierës pranë katër DRAP dhe ZVAP, të cilët vijuan më tej me trajnimin e mësuesve kujdestarë të klasave të 9-ta dhe të drejtuesve të institucioneve arsimore të të gjitha shkollave të arsimit bazë.

- Plani i promovimit dhe orientimit në karrierë i ndërtuar nga AKPA në funksion të rritjes së numrit të nxënësve në arsimin profesional.

Gjatë periudhës janar- qershor 2024 rezulton se 642 punekerkues te papune kanë ndjekur kursin aftësi digjitale prej të cilëve 59% i përkisnin grupmoshës 15-29 vjeç.

Diskutime mbi kërkesën dhe nevojën për të ndërtuar një program sistematik dhe të qëndrueshëm të orientimit në karrierë duke u bazuar mbi:

- praktikat më të mira ndërkombëtare,
- hartimin e praktikave më të mira kombëtare në orientimin në karrierë në arsimin profesional

Ky takim u mbështet nga UNICEF Albania, me financimin e Ambasciata d'Italia a Tirana në kuadër të projektit Qëndro, me qëllimin e mbështetjes për arritjen e qëllimeve të politikave në arsim.

Masa 2.1.3 është pjesërisht e realizuar

Masa 2.1.4 Nxitet dhe forcohet novacioni, përmes sipërmarrjeve rinore dhe nga të rinjtë duke e vënë novacionin rinor në fokus të kuadrit ligjor dhe politikave publike të Start Up-eve, politikave të punësimit dhe mbështetjes së nismave si co-working spaces.

Njw iniciativë e rëndësishme e Agjencisë Startup Albania është hapja e thirrjes për masa mbështetëse GRANT 2024, ku nëpërmjet një fondi prej 300 milionë lekësh, qeveria shqiptare ofron mbështetje financiare për startup-et më premtuese në Shqipëri. Thirrja Grant 2024 është dizajnuar për të identifikuar dhe mbështetur projektet më inovative dhe të qëndrueshme, duke u dhënë atyre burimet e nevojshme për të avancuar dhe për të realizuar qëllimet e tyre.

Këto nisma janë pjesë e angazhimit të vazhdueshëm të Agjencisë Startup Albania për të ndihmuar në krijimin e një mjedisi të fuqishëm dhe mbështetës për startup-et dhe aktorët e ekosistemit në Shqipëri. Me përkushtim dhe strategji të qarta, ne jemi të bindur që mund të bëjmë një ndryshim të rëndësishëm në zhvillimin e ekosistemit të startup-eve në vendin tonë.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar aktivitetet e mëposhtme:

- 2 Shkurt 2024 - Marrëveshje Bashkëpunimi për Shkollat Profesionale - Nënshkrimi i marrëveshjes për të fuqizuar bordet e shkollave dhe ndërlidhjen me tregun e punës.
- 27 Maj 2024- Vizita Zyrtare në Hungari: Përvoja dhe Praktika Pozitive. Gjatë vizitës në Budapest, përfaqësuesit shqiptarë u takuan me tre Sekretarë Shteti të Ministrisë për Ekonominë Kombëtare. Diskutimet u fokusuan në politikat, reformat dhe strukturat hungareze, si dhe projektet dhe programet kryesore sektoriale. U shkëmbyen përvoja të mira në fusha si investimet, teknologjia, inovacioni, rritja e pagave dhe ulja e papunësisë. Falë ekspertizës hungareze në ekonomi dhe arsim profesional, Shqipëria mbetet e hapur për bashkëpunim të mëtejshëm dhe tërheqjen e investitorëve hungarezë.

Masa 2.1.4 është e realizuar

Masa 2.1.5 Përmirësohen programet dhe shërbimet që ofrojnë mbështetje për lëvizshmërinë e të rinjve, dhe bashkëpunimin mes tyre brenda vendit dhe me gjerë.

Programi “Superschools” është një projekt i Rycos, që bëri bashkë përfaqësues të institucioneve të rëndësishme partnere, si zv. Ministren e Arsimit dhe Sportit, përfaqësues të Bashkimit Europian, Atashe të Ambasadës Gjermane, TBC, si dhe drejtues shkollash.

Në kuadër të “Skemës së Shkëmbimit të Shkollave të Ballkanit Perëndimor,” ky projekt ndihmon në rrjetëzimin e të rinjve, ndarjen e përvojave të tyre dhe ngritjen e urave të komunikimit.


Në dy ciklet e programit që nga viti 2022, 27 shkolla të mesme nga e gjithë Shqipëria kanë marrë pjesë në shkëmbimet shkollë me shkollë, ku janë përfshirë mbi 280 nxënës. Për ciklin e tretë në vitin 2024 ky projekt do të mbështesë edhe 16 shkolla të mesme.

Masa 2.1.5 është pjesërisht e realizuar

Masa 2.1.6 Lehtësohet transporti publik ndërqytetas për të rinjtë, duke rritur lëvizshmërinë e tyre në qarqe.

Masa 2.1.6 është e pa raportuar

Përmbledhje për Objektivin Specifik 2.1



Objektivi Specifik 2.2: Të rinjtë janë të informuar mirë për mundësitë arsimore të lidhura me tregun e punës dhe ju mundësohet i mësuar cilësor si në arsimin formal ashtu edhe në atë joformal duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe virtyteve të tyre.

Masa 2.2.1 Mbështeten të rejtat dhe të rinjtë në pikat kritike të zhvillimit, si kalimi në shkollën e mesme të lartë dhe kalimi nga shkolla në tregun e punës ose në studimet e nivelit universitar, me këshillim dhe informacione, që lidhin përzgjedhjen e fushës së arsimimit me mundësitë në tregun e punës, në bashkërendim me masat e parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026.

Në kuadër të Thirrjes nr. III për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, është financuar nga MSHRF dhe AKR Shoqata “LIBURNETIK”, e cila ka zhvilluar projektin me titull “Re-Debate, Kampionati Kombëtar i Debatit” me synim përfshirjen e 940 të rinjve në 21 bashki, Malësi e Madhe, Shkodër, Kukës, Mirditë, Lezhe , Dibër, Mat, Krujë, Durrës, Tiranë, Kamëz, Elbasan, Patos, Pogradec, Korçë, Berat, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë, Konispol. Nëpërmjet këtij projekti janë realizuar trajnime të vazhdueshme me të rinj të shkollave të mesme me qëllim nxitjen e aftësive të debatimit, lidershit, mendimit kritik dhe argumentimin e temave të ndryshme.

U realizuan aktivitete dhe workshope si vijon:

- 7 Mars 2024 -Rilindja e Shkollës së Mesme Profesionale “Nazmi Rushiti”, Peshkopi - Njoftimi për kushtet e reja dhe degët mësimore që do të ofrohen për 300 nxënës. Në këtë panair, organizatat e ndryshme do të prezantojnë programet e tyre edukative dhe mundësitë për punësim, duke ofruar këshillim dhe informacion të dobishëm për zgjedhjen e fushave të studimit.
- 9 Mars 2024 -Nderimi i Mësuesve të Arsimit Profesional në Ditën e Festës së Mësuesve - Rëndësia e profesionistëve të aftësisë profesionale dhe shkallët e punësimit pas diplomimit.
- 25 Mars 2024 -Workshope për Zhvillimin e Aftësive Sociale - Ky aktivitet ofroi ëorkshope për të rinjtë në lidhje me aftësitë sociale, si komunikimi dhe punë në ekip. Këto ëorkshope do të ndihmojnë në përgatitjen e të rinjve për kalimin nga shkolla në tregun e punës dhe në mësimin e mënyrave për të ndërtuar marrëdhënie profesionale të suksesshme.

Janë realizuar takime informuese me nxënës të arsimit të mesëm të lartë, mësues kujdestarë, drejtues institucionesh, përfaqësues të Qendrës Multifunksionale, të Drejtorisë së Kulturës dhe Rinisë në Bashkinë Berat, mbi promovimin e platformës “Të rinjtë për të rinjtë”, mundësi që atyre ju ofrohen për mësim dhe zhvillim përmes njohjes me programet rajonale dhe ndërkombëtare, të tilla si : Programi Erasmus +, Horizon 2020 etj.

Në bashkëpunim me specialistët e SMIP, është përgatitur “Materiali informues për plotësimin e formularëve të orientimit të karrierës për nxënësit e klasës së 9-të, që do të ndjekin arsimin e mesëm të lartë”. Gjatë muajit maj 2024, janë zhvilluar veprimtari trajnuese/informuese lidhur me plotësimin e formularëve të orientimit të karrierës për nxënësit e klasës së 9-të që do të ndjekin arsimin e mesëm të lartë. Janë trajnuar 56 specialistë të caktuar si koordinatorë të orientimit të karrierës pranë katër DRAP dhe ZVAP, të cilët kanë vijuar më tej, me trajnimin e mësuesve kujdestarë të klasave të 9-ta dhe të drejtuesve të institucioneve arsimore të të gjitha shkollave të arsimit bazë.

Nga bashkëpunimi i Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar me institucionet arsimore dhe me Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, janë realizuar:

- Takime periodike ndërgjegjësuere në bashkëpunim edhe me parlamentin Rinor dhe grupimet e tjera të fëmijëve në lidhje me krijimin e një mjedisi pozitiv e miqësor në shkolla me fokus të veçantë parandalimi i braktisjes të shkollës dhe përfundimin e arsimit të mesëm ose atij profesionale.
- Ofrimi i trajnimeve të drejtpërdrejta mbi aftësitë e punësimit: Programet e trajnimit për të rinjtë duhet të përfshijnë aftësi të buta (soft skills) si komunikimi, punë në grup, menaxhimi i kohës dhe zgjidhja e problemeve.
- Organizimi i seminareve dhe punëtorive për orientimin e karrierës: Këto aktivitete kanë ndihmuar të rinjtë të kuptojnë mundësitë që ofron tregu i punës, duke i ndihmuar ata të ndërtojnë plane të qarta karriere.
- Këshillim dhe mentorim individual: Këshilluesit e karrierës përnjë IAP-ve kanë ndihmuar të rinjtë të analizojnë pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe të përcaktojnë qëllimet e tyre të karrierës. Gjithashtu, mentorët nga fusha të ndryshme profesionale kanë ofruar mbështetje dhe udhëzime të duhura.
- Qasja në platforma të avancuara të teknologjisë së informacionit: Përmes aplikacioneve dhe platformave online, të rinjtë kanë patur dhe janë njohur të kenë qasje të orientimit të karrierës, informacione për tregun e punës dhe mundësi për punësim.
- Promovimi i praktikave profesionale dhe intership-eve: Praktikave profesionale i kanë dhënë të rinjtë përvojë reale në botën e punës dhe i kanë ndihmuar të krijojnë kontakte të vlefshme në rrjetet e tyre profesionale.
- Bashkëpunimi me bizneset lokale: Bizneset dhe organizatat kanë ofruar mundësi për praktika, trajnime dhe vende pune për të rinjtë, duke i ndihmuar ata të fitojnë përvojë praktike dhe të krijojnë një bazë për karrierën e tyre të ardhshme, p.sh.: (hoteleri, turizëm, marketing)
- Nisma “Toka në Shkollë” vazhdon të zbatohet për të gjitha institucionet e arsimore të Arsimit Parauniversitar, si dhe në 200 shkollat Qendra Komunitare, që zbatojnë Programin Kombëtar “Art, zeje, sport” për veprimtaritë Jashtë Orëve Mësimore (JOM).
- “Shëndeti, sporti dhe mjedisi” në kuadrin ligjor të politikave për mbrojtjen e shëndetit dhe të shtrirjes së edukimit shëndetësor në institucionet dhe kurrikulat e arsimit parauniversitar. Aktivitete në fushën e ndërgjegjësimit për ruajtjen e mjedisit. Fushata sensibilizuese mbi mbrojtjen e pyjeve, mbajtjen pastër të mjedisit, riciklimi.

- Shkëmbime të ekeperiencave midis shkollave të mesme të rajonit, në kuadër të projektit Eastern Balkans School Exchanges “Super Schools”, të zbatuar nga RYCO. Ka përfunduar aplikimi dhe përygjedhja e shkollave të mesme, të cilat do të jenë pjesëmarrëse në projektin Eastern Balkans School Exchanges “Super Schools”, për vitin shkollor 2024-2025.
- Trajnim me drejtues, mësues të edukimit fizik të IAP-ve tona ku zbatohet programi kombëtar " Ekipe sportive në shkolla" në disiplinat e ndryshme sportive, si: volejboll, basketboll, futboll me qëllim njohjen dhe zbatimin e këtij programi që ka në fokus promovimin e jetës së shëndetshme sportive, largimin e të rinjve nga zakonet jo të mira që sjellin pasivitet në jetën e tyre sociale, si dhe t'i ndihmojë ata që të shpenzojnë kohën pas orarit mësimor në mënyrë cilësore.
- Zhvillimi i aktiviteteve/garave sportive në nivel shkolle, midis shkollave dhe në nivel qarku me qëllim nxitjen e të rinjve për pjesëmarrjen në këto aktivitete dhe ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë që ato kanë në sigurimin e një jetese të shëndetshme.
- “Shëndeti, sporti dhe mjedisi” në kuadrin ligjor të politikave për mbrojtën e shëndetit dhe të shtrirjes së edukimit shëndetësor në institucionet dhe kurrikulat e arsimit parauniversitar. Aktivitete në fushën e ndërgjegjësimin për ruajtjen e mjedisit. Fushata sensibilizuese mbi mbrojtjen e pyjeve, mbajtjen pastër të mjedisit, riciklimi.

Gjatë periudhës raportuese u çel fillimi i Praktikës Profesionale për të Rinj, nga Zyra e Punës ku 20 të rinj të sapodiplomuar filluan praktikën përmes programeve të nxitjes së punësimit.

Më 16 Prill 2024 u shpallën Fituesit e Thirrjes së Tretë në Kuadër të Fondit Rajonal të Sfidave (RCF), një iniciativë për të rritur punësueshmërinë dhe për të forcuar konkurrueshmërinë e sipërmarrjeve në Ballkanin Perëndimor, me fokus të rinjtë. Ky fond, me një vlerë prej 10 milion Euro, është krijuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Punësimit, Aftësimin dhe Sigurimeve Shoqërore në bashkëpunim me Ambasadën e Gjermanisë dhe përfaqësuesit e KfW dhe Bashkëpunimit Zvicerian për Zhvillim. Dhjetë fitues u shpallën, nga të cilat 7 janë institucione publike të arsimit dhe formimit profesional.

Masa 2.2.1 është e realizuar.

Masa 2.2.2 Promovohet përdorimi i sigurt i teknologjive të reja dhe mbështetet përvetësimi i aftësive dhe kompetencave digjitale të shekullit të 21-të për të rinjtë, si në sistemin arsimor të përgjithshëm dhe atë profesional ashtu edhe në sistemin e trajnimeve formale dhe jo-formale

Në kuadër të kësaj mase, janë realizuar:

10 Mars-Trajnimit për Aftësi Digjitale - Ky aktivitet do të ofrojë trajnime për të rinjtë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Trajnimet do të fokusohen në përvetësimin e mjeteve dhe aplikacioneve digjitale që janë të rëndësishme për tregun e punës, si dhe zhvillimin e aftësive të nevojshme për punë në sektorin teknologjik.

4 Mars 2024 u zhvillua aktiviteti "Udhët e Karrierës" në Shkollën 9-vjeçare “Qemal Mici”, Durrës 150 nxënës, prindër, mësues dhe biznese informohen mbi mundësitë e arsimit dhe formimit profesional.

Më 7 Mars, gjatë periudhës raportuese Shkollës e Mesme Profesionale “Nazmi Rushiti”, Peshkopi, u rihap me kushte të reja dhe degë mësimore që do të ofrohen për 300 nxënës.

24 Prill 2024 në Dibër, u mbajtën sesione informimi për të rinjtë mbi kërkimin e punës online dhe shërbimet e tjera digjitale. Të rinjtë u njohën me mundësitë që ofron Zyra e Punës, duke përfshirë praktikën profesionale dhe programin e vetëpunësimit.

Masa 2.2.2 është pjesërisht e realizuar

Masa 2.2.3 Mbështeten dhe zhvillohen programe të seksioneve sportive amatore, arteve, artizanatit dhe aktiviteteve të tjera jashtë-kurrikulare që synojnë zhvillimin e aftësive për jetë të shëndetshme, me fokus të veçantë tek të rejtat.

15 Mars-Festivali i Artit dhe Kulturës për Rininë - Ky aktivitet shërbeu për të promovuar aktivitete kulturore dhe artistike që përfshijnë artin dhe sportin. Festivali do të ofrojë mundësi për të rinjtë për të shfaqur aftësitë e tyre në një ambient mbështetës, duke inkurajuar gjithashtu angazhimin e tyre në aktivitete jashtë-kurrikulare dhe zhvillimin e një stili të shëndetshëm jetese.

➤ Programi Jashtë Orarit Mësimor.

Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar takime me FSHZH për fillimin e punës në praktikë për zbatimin dhe pilotimin e nivelit të dytë të programit JOM në Thumanë. Realizuar takimet me të gjitha federatat e interesuara (Bilardo, Ping Pong, Shah, Peshëngritje, Mundje, Xhudo, Tawekendo, Basketball, Volejboll) dhe përpunuar i gjithë informacioni sa i përket infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e kurseve sportive në Thumanë.

Gjithashtu janë zhvilluar takime me World Vision dhe Save the Children për shprehjen e interesit për të mbështetur ngritjen e qendrës multifunksionale në Thumanë.

Finalizuar dhe firmosur nga të gjithë aktorët marrëveshja e bashkëpunimit shumëpalëshe për realizimin e programit “Kampi veror për Fëmijë”, në njësinë administrative Thumanë, për periudhën 6 Gusht - 6 Shtator 2024.

Vazhdon zbatimi i nismës "Toka në Shkolla" për të gjithë IA të APU-së, si dhe 200 shkolla SHQK që zbatojnë Programin Kombëtar "Art, zeje, sport" për veprimtarinë JOM.

Në 200 shkolla SHQK vazhdon zbatimi Programin Kombëtar "Art,zeje,sport" për veprimtarive JOM

➤ Ekipet Sportive

Gjatë periudhës raportuese ka vijuar zbatimi i Programit të Ekipeve Sportive. Më datë 20 prill 2024, në kampionatin miqësor të volejbollit të mbajtur në Sarandë u angazhuan 60 të rinj nga 6 gjimnaze të Sarandës, Konispolit dhe Delvinës me qëllim nxitjen e përfshirjes së të rinjve në aktivitete sportive. Ky program ka si qëllim të promovojë jetën e shëndetshme sportive, të largojë të rinjtë nga zakonet jo të mira që sjellin pasivitet në jetën e tyre sociale, si dhe t'i ndihmojnë ata që të shpenzojnë kohën pas orarit mësimor në mënyrë cilësore.

Për Edicionin e 2 të projektit Ekipet Sportive në Shkolla kanë marrë pjesë 10,182 sportistë të ndarë në 773 ekipe. Këto ekipe stërviten nga 397 trajnerë në 274 shkolla nga ku 178 shkolla 9-vjeçare dhe 96 shkolla të mesme në të gjithë Republikën e Shqipërisë.

Trajnerë për ekipet e shkollave 9-vjeçare janë 201, për shkollat e mesme 130 dhe trajnerë të ekipeve U10 janë 66.

Në total për ciklin 9-vjeçar dhe ciklin e mesëm janë:

- Basketboll janë 3386 nxënës, 256 ekipe.
- Volejboll janë 5225 nxënës, 394 ekipe.

- Volejboll dhe Basketboll 1571 nxënës të ekipeve U10.
- Basketboll 9-vjeçare janë 165 ekipe nga ku 83 ekipe vajza dhe 82 ekipe djem.
- Basketboll 9-vjeçare janë 2249 nxënës nga ku 1103 vajza dhe 1094 djem.
- Basketboll E Mesme janë 91 ekipe nga ku 44 ekipe vajza dhe 47 ekipe djem.
- Basketboll E Mesme janë 1189 nxënës nga ku 575 vajza dhe 614 djem.
- Volejboll 9-vjeçare janë 228 ekipe ne total nga ku 115 ekipe vajza dhe 113 ekipe djem.
- Volejboll 9-vjeçare janë 3034 nxënës nga ku 1539 vajza dhe 1495 djem.
- Volejboll E Mesme janë 166 ekipe nga ku 82 ekipe vajza dhe 84 ekipe djem.
- Volejboll E Mesme janë 2191 nxenes nga ku 1082 vajza dhe 1109 djem.

Ekipet U10 janë 731 nxënës volejboll nga ku 380 vajza dhe 351 djem si dhe 840 nxënës basketboll nga ku 428 vajza dhe 412 djem.

Për periudhën Mars – Maj 2024 numri i ndeshjeve është 899.

Kampionatet sportive në bashkëpunim me Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH)

Gjatë periudhës raportuese janë porositur uniformat për fillimin e edicionit 2024-2025 si dhe kampionati fillon në mars 2025.

Janë regjistruar rreth 12 000 nxënës në programin “Ekipet Sportive në Shkolla” për vitin shkollor 2024-2025.

Më 25-26 maj u zhvilluan kampionatet e basketbollit dhe volejbollit, për vajza dhe për djem, për 9 vjeçare dhe gjimnaze, ku u kurorizuan ekipet fituese të secilës disiplinë, ku morën pjesë mbi 700 ekipe.

➤ Aktivitete të tjera


Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në “Robotech” ku u shpalosën ide novatore nga të rinjtë, së bashku me aktorë nga ekosistemi në një event unik dedikuar talenteve të të rinjve në robotikë. Ku i dorëzoi çmimin “Skuadra më e mirë”, skuadrës së gjimnazit “Partizani”.

Masa 2.2.3 është e realizuar

Përmbledhje për Objektivin Specifik 2.2

NUMRI I MASAVE	TË PARAPORTUARA	TË RAPORTUARA
3	0	3
100%	0%	100%

NUMRI I MASAVE	PLOTËSISHT TË REALIZUARA	PJESËRISHT TË REALIZUARA	TË PAREALIZUARA
3	2	1	0
100%	66%	34%	0%



Objektivi Specifik 2.3: Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.

Masa 2.3.1 Nxiten punët e denja dhe të përshtatshme për të rejtat dhe të rinjtë përmes politikave të punësimit, miqësore dhe të orientuara nga të rinjtë, që kontribuojnë në krijimin e vendeve të punës për të rejtat dhe të rinjtë dhe që sigurojnë qasje novative dhe digjitale në informacionet mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e punësimit

Në vijimësi të zbatimit të SKR29 dedikuar të rinjve dhe informimit të tyre mbi mundësitë lokale, kombëtare në arsim, trajnim dhe punësim, **në datë 29 Janar 2024** në qytetin e Dibrës u zhvillua "Panairi i Edukimit, Trajnimit dhe Punësimit", me qëllim njohjen e mundësive për arsim, trajnim dhe punësim për të rinjtë, në përputhje me profesionet, dëshirat dhe kërkesat e tregut dhe të ndërthurura me promovimin e vlerave turistike dhe kulturore të Dibrës.

Në datën 2 Shkurt 2024 në qytetin e Gjirokastrës u zhvillua Panairi i “Edukimit, Trajnimit dhe Punës”. Në këtë panair morën pjesë rreth 300 të rinj, të cilët patën mundësi të eksploronin të gjitha mundësitë lokale për të rinjtë, për arsim, trajnim dhe punësim, të prezantuara këto nga 30 aktorë që ofrojnë shërbime për të rinjtë, si dhe mundësi kombëtare si: Programi i Kodimit, Programi Kombëtar i Praktikave të Punës dhe Garancinë Rinore. Të rinjtë kuriozë dhe me dëshirë të madhe për tu zhvilluar akademikisht dhe profesionalisht, vizituan çdo stendë duke u informuar për fushat e tyre të interesit, për të ndjekur më tej mundësitë si dhe për ti ndarë ato me miqtë e tyre.

Në datë 29 Mars 2024 u zhvillua panair për të rinjtë në çdo qark në qytetin e Fierit. Të rinjtë të Bashkisë Fier iu bashkuan Panairit të Edukimit, Trajnimit dhe Punësimit, për tu informuar për mundësi lokale e kombëtare që i ndihmojnë për tu zhvilluar më tej. Nëpërmjet 30 aktorëve pjesëmarrjes, biznese dhe organizata, të cilët informuan të rinjtë lidhur me shërbimet që ofrojnë dhe mundësitë e punësimit.

Në datë 19 Prill 2024 Në qytetin e Beratit, u zhvillua “Panairi i Edukimit, Trajnimit dhe Punësimit”. Pjesë e panairit ishin institucione arsimore private dhe publike, institucione lokale dhe vendore dhe aktorë nga bota e biznesit etj., për të prezantuar të rinjtë me shërbimet dhe mundësitë që ofrojnë e tyre.

Masa 2.3.1 është realizuar

Masa 2.3.2. Sigurohet mbështetje e përshtatshme dhe miqësore për të rinjtë dhe të rejtat e në veçanti për ata me aftësi të kufizuara mbi punësueshmërinë e tyre dhe sipërmarrjen rinore 2027-2029

Programet aktive të tregut të punës për PAK

LLOJI I PROGRAMIT	JANAR - QERSHOR 2024		
	TOTAL (PAK)	15 - 29 VJEC (PAK)	%
PUNËSIM ME NDERMJETËSIM NGA ZYRAT E PUNËS	183	60	33%
PJESËMARRJE NË PNP	71	24	34%
FORMIM PROFESIONAL	74	18	24%
TOTAL	328	102	31%

Masa 2.3.2 është pjesërisht e realizuar

Masa 2.3.3 - Nxitet dhe promovohet novacioni në tregun e punës për punësimin me kohë të pjesshme të orientuar kryesisht nga të rejtat.

Masa 2.3.3 nuk është realizuar

Masa 2.3.4. Fuqizohen qasjet e integruara për të mbështetur të rinjtë që rrezikojnë lënien e parakohshme të shkollimit dhe pa mbështetje për shkollim në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit (Garancia Rinore dhe UNICEF)

Në përputhje me angazhimet e vendeve të Ballkanit Perëndimor për të siguruar përfshirjen e qëndrueshme në tregun e punës të të rinjve të moshave 15-29 vjeç, Shqipëria ka përgatitur dhe miratuar Planin e Zbatimit të Garancisë Rinore (YGIP) 2023-2024. Siç parashikohet në Rekomandimin e Këshillit Evropian për Një Urë drejt Punësimit – Përforcimi i Garancisë Rinore (2020), Garancia Rinore siguron akses universal për të gjithë individët e rinj nën 30 vjeç që nuk janë të përfshirë në arsim, aftësim apo punësim (NEET), koherencë dhe koordinim të politikave – bazuar mbi partneritete të ndryshme - me qëllim "garantimin" e një oferte cilësore brenda katër muajve, monitorimin e vazhdueshëm dhe përdorimin efektiv të burimeve financiare vendase dhe të tjera. Projekti “BE-ja për rininë” synon të përmirësojë punësueshmërinë e të rinjve dhe të rejave, që nuk janë në punësim, arsim apo formim, nëpërmjet mbështetjes për zbatimin e skemës së Garancisë Rinore në Shqipëri.

Lidhur me 6-mujorin e parë të 2024, ka filluar pilotimi dhe aftësimi dhe forcimi i strukturave të qeverisjes së Garancisë Rinore në nivel qendror dhe vendor, duke siguruar angazhimin e të rinjve dhe partnerëve socialë. Mbështetja e zhvillimit të një modeli për Rrjetet e Partnerëve Vendorë (kontaktimi dhe përgatitja). Ngritja dhe aftësimi i Rrjeteve të Partnerëve Vendorë në bashkitë e Tiranës, Vlorës dhe Shkodrës. Mbështetja e krijimit të partneriteteve të Garancisë Rinore në terren, nëpërmjet mënyrave novatore të angazhimit dhe bashkë-konceptimit. Ofrimi i asistencës teknike

për të përmirësuar disponueshmërinë e informacioneve periodike dhe gjithëpërfshirëse mbi NEET në Shqipëri. Ofrimi i komunikimit efikas dhe promovimi i skemës së Garancisë Rinore në të tre bashkitë. Faza e pilotimit po zbatohet nga AKPA, në bashkëpunim me UNICEF/UNDP.

Zbatimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm në shkollat profesionale (projekt në bashkëpunim me UNICEF)

AKPA në bashkëpunim me UNICEF Shqipëri po starton projektin "Zbatimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm dhe të nxënimit socio-emocional në shkollat e arsimit profesional për parandalimin e braktisjes së shkollës". Eshtë zhvilluar event i lancues i projektit: Ngritja e sistemit parandalues për braktisjen dhe të nxënimit socio - emocional në arsimin profesional.

Në vijim të eventit startues të projektit "Zbatimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm dhe të nxënimit socio-emocional në shkollat profesionale", të zbatuar nga UNICEF Shqipëri në bashkëpunim me AKPA, u zhvilluan dhe trajnime të parë, të ndarë në tre grupe:

Gjatë periudhës prill-qershor 2023 janë zhvilluar 2 sesione trajnuese me pjesëmarrjen e nëndrejtorëve, psikologut, punonjësit social, koordinatorit të orientimit të karrierës, koordinatorit të trajnimit të mësuesve, koordinatorit të gjurmimit, si dhe përfaqësues nga administrata e konvikteve të shkollave të mesme profesionale.

Përfituesit e projektit për vitin 2023 janë:

- +200 punonjës arsimorë në shkollat profesionale të trajnuar dhe mentoruar për zbatimin e Sistemit të Paralajmërimit të Herëshëm (përfshirë mësuesit e lëndëve të përgjithshme dhe profesionale, përfaqësuesit nga Njësia e Zhvillimit, psikologët & punonjësit socialë)
- +150 nxënës të shkollave profesionale të mentoruar për ndarjen e ideve mbi projektet e parandalimit të braktisjes dhe aktivitetet e bashkëmoshatarëve
- +100 plane individuale të parandalimit të braktisjes së nxënësve të shkollave profesionale
- 14 shkolla profesionale në 6 rajone
- 15 ekspertë arsimorë
- 6 punonjës nga AKPA të trajnuar për monitorimin e Sistemit të Paralajmërimit të Herëshëm dhe të nxënimit socio-emocional

Nëpërmjet analizimit të faktorëve të riskut, treguesve, do të ngrihet dhe zbatohet një sistem i parandalimit të hershëm të braktisjes së shkollave, nëpërmjet ngritjes së grupeve të punës, ku çdo person përgjegjës do të ketë rol të përcaktuar dhe do të kontribuojnë në parandalimin e këtij fenomeni.

Ky projekt ka vijuar të zbatohet në shkollat e arsimit profesional dhe në 6 mujorin e parë të vitit 2024.

TREGUESIT/INDIKATORET

- % e të rinjve që janë përfshirë në programet e nxitjes së punësimit:

Gjatë periudhës Janar- Qershor 2024 rezultojnë rreth 7,538 punëkërkuës të papunë të grupmoshës 15-29 vjeç të cilët janë përfshirë në programet aktive të tregut të punës. Numri më i lartë i të rinjve paraqitet në punësim dhe formim, ndërsa pjesëmarrja në programet e nxitjes së punësimit mbetet e kushtëzuar nga fondet në dispozicion për këto programe.

Pu.pa 15-29 vjeç pjesëmarrës në Programet Aktive të Tregut të Punës

	TOTAL (PAK)	15 - 29 VJEC (PAK)	%
PUNËSIM (NËPËRMJET ZYRAVE TË PUNËS)	4,636	12,886	36%
NXITJE PUNËSIMI (PNP)	776	1,787	43%
FORMIM PROFESIONAL	2,126	3,944	54%
TOTAL PATP	7,538	18,617	40%

Masa 2.3.4 është realizuar

Përmbledhje për objektivin specifik 2.3

Përmbledhje për Objektivin Specifik 2.3

NUMRI I MASAVE	TË PARAPORTUARA	TË RAPORTUARA
4	0	4
100%	0%	100%

NUMRI I MASAVE	PLOTËSISHT TË REALIZUARA	PJESËRISHT TË REALIZUARA	TË PAREALIZUARA
4	2	1	1
100%	50%	25%	25%



QËLLIMI POLITIK III – Mirëqenia dhe Përfshirja

Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti).


Qëllimi i Politikave III, ka në përmbajtje të tij 3 Objektiva Specifike dhe 15 Masa. Ky qëllim politik zërthehet në masa që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë e të rinjve, duke përfshirë dhe hapësirën digjitale, gjithëpërfshirjen, tolerancën dhe të drejtat e njeriut dhe të pakicave, mirëqëniën dhe shërbimet miqësore, shëndetin mendor dhe psikologjik, shëndetin riprodhues, programet e strehimit dhe hapësirave publike për të rinjtë.

Përmbledhje për Qëllimin Politik 3

NUMRI I MASAVE	TË PARAPORTUARA	TË RAPORTUARA
15	0	15
100%	0%	100%

NUMRI I MASAVE	PLOTËSISHT TË REALIZUARA	PJESËRISHT TË REALIZUARA	TË PAREALIZUARA
15	11	3	1
100%	73%	20%	7%

Qëllimi Politik III



Më poshtë paraqitet një panoramë e detajuar mbi hapat konkretë të ndërmarrë gjatë periudhës raportuese, me qëllim realizimin e masave të parashikuara për secilin objektiv specifik.

Objektivi specifik 3.1. Mbrojtja mbështetja dhe siguria e të rejave dhe të rinjve, veçanërisht e atyre në situatë rreziku, në vendin ku jetojnë dhe hapësirën digjitale

Masa 3.1.1 Bashkërendohet zbatimi i Strategjive dhe programeve Kombëtare të Mbrojtjes dhe Sigurisë me një fokus të veçantë tek prezenca virtuale e të rinjve online, krijimi i hapësirave të sigurta, krimi kibernetik dhe bullizmi online (digjital).

Kjo masë konvergjon me qëllimet dhe objektivat specifikë të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025, sa i përket internetit të sigurt dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve online, ku në kuadër të kësaj Strategjie dhe Strategjisë Kombëtare të Rinisë, AKCESK, gjatë periudhës raportuese, ka hartuar materiale trajnimi dhe ka organizuar aktivitete, me qëllim ndërgjegjësimin dhe rritjen e kapaciteteve sa i përket sigurisë dhe mbrojtjes së fëmijëve në internet, për fëmijët, prindërit, mësuesit, punonjësi social, përfaqësues të organizatave joqeveritare etj.

AKCESK, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHMDF), organizoi konferencën me temë “Një hapësirë kibernetike më e sigurt për fëmijët” më 6 Shkurt 2024. Gjatë këtij event, u përmyll me sukses nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy institucioneve, e cila synon të përmbushë objektivat për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve në mjedisin online².

Për periudhën raportuese, janar-qershor 2024 janë realizuar 4 workshope trajnuese dhe 12 aktivitete ndërgjegjësuere në qytete të ndryshme të vendit. Workshopet trajnuese janë realizuar në 4 bashki: Durrës, Kukës, Cërrik, Përmet. Deri tani janë trajnuar 135 profesioniste si: Punonjës për mbrojtjen e fëmijës, përfaqësues nga institucioneve nga drejtorite vendore të policisë, drejtoritë vendore të krimit kibernetik, zyra vendore e arsimit, prokuroria, shërbimet sociale të bashkive, gjithashtu edhe oficerë sigurie në shkolla, drejtues shkollash, mësues e stafet psikosociale të shkollave. 12 aktivitete ndërgjegjësuere janë realizuar me fëmijë të shkollave 9 vjecare dhe të mesme në qytetet Durrës, Tiranë, Berat, Kukës, Cërrik, Lezhë, Kuçovë, Gramsh, Fier, Shkodër, Gjirokastrë, Përmet. Në këto aktivitete janë ndërgjegjësuar 460 fëmijë dhe 43 prinder.

Workshop-et janë zhvilluar në kuadër të ndërgjegjësimit të fëmijëve dhe të rinjve për një hapësirë kibernetike më të sigurt, duke i sjellë në vëmendje nga njëra anë kontributet pozitive që ka zhvillimi i teknologjisë por nga ana tjetër ndërgjegjësim për rreziqet e shumta me të cilat mund të përballen në raste të përdorimit në mënyrë të papërshtatshme të hapësirës digjitale.

Në vazhdim të fushatës për ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi higjienën kibernetike dhe mbrojtjen nga kërcënimet kibernetike, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKCESK) organizoi një seri trajnimesh me temën “Higjiena kibernetike dhe praktikat më të mira të sigurisë”. Këto trajnime u realizuan më 12-13 Shkurt dhe 29-30 Maj, në qytetet e Tiranës dhe Vlorës.

Në kryesinë e Kuvendit të Shqipërisë, u zhvillua një seancë publike me temën “Interneti i sigurt”, ku ishin të ftuar Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, Ministria e

² Për më shumë informacione klikoni në këtë faqe: <https://aksk.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/Buletin-5-9-Shkurt-2024.pdf>.

Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Policia e Shtetit dhe AKCESK. Gjatë kësaj seance, këto institucione paraqitën para Grupit të Deputetëve “Miq të Internetit” disa nga masat për sigurinë online të fëmijëve. Organizata të shoqërisë civile që punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve ndanë gjithashtu disa aktivitete të tyre dhe disa rekomandime lidhur me parandalimin e hershëm dhe mbrojtjen e fëmijëve prej bullizmit, shantazhimit dhe abuzimit online.³

AKCESK, me mbështetjen e UNICEF, organizoi Tryezën e Rrumbullakët me temë “Bashkëpunimi Ndërinstitucional për Mbrojtjen e Fëmijëve në Internet”. Në këtë takim morën pjesë Znj. Nina Guga Zv. Ministër i Arsimit dhe Sportit, Znj. Alma Tandili Kryetare e ASHDMF, përfaqësues nga UNICEF, Policia e Shtetit, Shërbimi Social Shtetëror, Alo 116 111, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, QPKMR si dhe përfaqësues nga Isigurt.al.

Në këtë tryezë u theksua nevoja urgjente për të diskutuar rreziqet e shtuara nga trendet e reja të aplikacioneve, si dhe masat që institucionet duhet të ndërmarrin së bashku për të rritur sigurinë e fëmijëve në internet. Koordinimi ndërinstitucional për të adresuar çështjet e bullizmit në internet dhe nevoja për të ngritur mekanizma efektive për të mbrojtur fëmijët është një nga prioritetet e AKCESK dhe institucioneve të tjera përgjegjëse⁴.

AKCESK do të vazhdojë punën në bashkëpunim me institucionet përkatëse për ngritjen e mekanizmave ndërvepruese ndërinstitucionale dhe organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe trajnimeve, për sigurinë online të fëmijëve dhe të rinjve, si detyrë funksionale dhe në kuadër të përmbushjes së objektivave të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025.

Ministria e Arsimit dhe Sportit, në kuadër të kësaj mase dhe në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), kanë krijuar një faqe të posaçme për raportimin e përmbajtjeve të paligjshme gjatë shfletimit në internet⁵. Ky shërbim synon të ndihmojë fëmijët dhe të rinjtë të raportojnë lidhje të paligjshme/të dëmshme, që hasen gjatë shfletimit në internet. Raportimet trajtohen me konfidencialitet të plotë nga autoritetet përgjegjëse për të ndërmarrë veprimet e duhura, si dhe për të marrë masa të menjëhershme ndaj këtyre përmbajtjeve.

Në faqen zyrtare të MAS-it, dhe institucioneve vartëse të saj, që lidhen me portalin online www.cesk.gov.al të AKCESK-ut, është vënë në funksion shërbimi “Raportoni përmbajtje të paligjshme”, për bllokimin e aksesit në faqet e internetit me përmbajtje të paligjshme.

Shërbimi Psiko-Social ka zhvilluar takime informuese/ndërgjegjësuese me tematika:

- “Fëmijë të sigurt në internet. Si të lundrosh i sigurt në internet”;
- “Fëmijë të sigurt në internet dhe mbrojtja nga dhuna virtuale”.

Policia e shtetit ka zhvilluar takim me nxënësit e gjimnazeve, dhe shkollave 9- vjeçare për rreziqet në internet dhe për bullizmin, nëpërmjet të cilës janë informuar nxënësit ku duhet të drejtohen dhe

³ Për më shumë informacione klikoni në këtë faqe: <https://aksk.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/Buletini-javor-19-23-Feb-2024.pdf>.

⁴ Për më shumë informacione klikoni në këtë faqe: <https://aksk.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Buletin-29-03-maj.pdf>

⁵ Për më shumë informacione klikoni në këtë faqe: <https://cesk.gov.al/raporto/>

gadishmërinë e tyre në raste të sulmeve kibernetike apo shantazheve online. Tematika që trajtohen në mënyrë ciklike nga mësuesit e qytetarisë, shërbimi psiko-social dhe oficerët e sigurisë në të gjitha shkollat.

Bazuar në dokumentin “Kudri evropian për kompetencën dixhitale të mësuesve, DigComEdu1”, në kudrin e kompetencave të TIK për mësuesit (ICT CFT, versioni 3) ASCAP-i ka hartuar:

- Modulet dhe materialet për trajnimin e mësuesve;
- Qytetaria dixhitale dhe siguria në internet në mjediset dixhitale.

ASCAP ka zhvilluar dokumentin “Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit”, i cili pjesërisht synon të kuptojë parimet bazë të sigurisë kibernetike, të edukimit mediatik dhe informacionit.

Për funksionimin e shërbimit psiko-social janë miratuar dy dokumente, të cilat trajtojnë edhe situatat e dhunës, bullizmit dhe abuzimit online në shkolla:

- Praktika e punës së shërbimit psiko-social;
- Parimet e përgjithshme etike të shërbimit psiko-social.

Shërbimi psiko-social zhvillon pyetësorë në lidhje me perceptimin e bullizmit dhe dhunës në shkollë nga nxënësit, si dhe organizon sesione informuese për nxënësit për abuzimin online dhe bullizmin online në shkollë.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese, janë zhvilluar konkurse dhe projekte me temën “Siguria në Internet”, si dhe Olimpiada e TIK-ut, si mundësi për të zbuluar talente në TIK. Janë krijuar platforma dhe janë trajnuar rreth 1200 mësues të TIK-ut për përdorimin e këtyre platformave, të cilat synojnë përdorimin e përmbajtjes digjitale brenda kurrikulës me kompetenca, për përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe për sigurinë kibernetike.

Mësuesit e shkollës janë gjithashtu të trajnuar dhe të përgatitur për të rritur sigurinë e fëmijëve përmes:

- Hartimit të rregullave shkollore për rritjen e sigurisë së fëmijëve në shkollë;
- Krijimit të videove ndërgjegjësuere nga nxënësit e shkollave për sigurinë kibernetike.

Marrja e hapave për zbatimin e mëtejshëm të kësaj mase do të shtrihet në gjithë periudhën e parashikuar në Strategjinë Kombëtare të Rinisë.

Kjo masë konvergjon me qëllimet dhe objektivat specifike të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025, sa i përket internetit të sigurt dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve online, ku në kudër të kësaj Strategjie dhe Strategjisë Kombëtare të Rinisë.

Në datat 27 prill, 25 maj dhe 30 Maj 2024 në qytetin e Tiranës u zhvilluan trajnime motivuese me titull “Digital Entrepreneur for a Day”, në kudër të projektit “Unlock your Technological Skills”. Ky projekt po vihet në zbatim nga Youth Rise Center me mbështetjen financiare të MSHRF-së dhe AKR-së.

Në kuadër të thirrjes III për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë “Qendra Youth Rise” ka zbatuar projektin me titull “Unlock Your technological Skills” i cili synon përfshirjen e 150 të rinjve në trajnimet digjitale në Bashkitë Kamëz, Fier, Tiranë dhe Shkodër. Për periudhën Janar-Shkurt 2024 organizata ka realizuar trajnime periodike lidhur me Cyber Security, me krijimin e faqeve web FrontEnd dhe zhvillimin e kodeve në PHP BackEnd.

Në kuadër të Thirrjes Nr. III për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë financuar nga MSHRF dhe AKR Shoqata e Bashkuar Qendra “Konkret” ka zhvilluar projektin me titull “Dedicated, Determined and Driven Youth of Elbasan” i cili synon të impaktojë 300 të rinj në Bashkitë Elbasan, Librazhd dhe Gramsh. Në fazën e parë të projektit janë realizuar 3 (tre) manuale në të cilat trajtohen çështje të higjenës kibernetike, sigurisë kibernetike dhe punësimin në këtë fushë, të cilat do të vijnë me realizimin e trajnimeve.

Masa 3.1.1 është e realizuar

Masa 3.1.2. Fuqizohen programet që trajtojnë çështjet dhe rreziqet e sigurisë me të cilat përballen të rejtat dhe të rinjtë e trafikuar, rreziqet e formave të ndryshme të krimit dhe parandalimi dhe luftimi i dhunës seksuale me bazë gjinore dhe dhunës nga partneri ndaj grave të reja, parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore/të rinjve.

Në kuadër të Strategjisë së Sigurisë në Komunitet, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është institucion kontribuues në hartimin e Planit të Ri të Veprimit 2024-2026 për këtë Strategji, me në krye Ministrinë e Brendshme.

Nisma “Shkolla të Sigurta”, një projekt i përbashkët mes Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ka për qëllim krijimin e një mjedisi të sigurt dhe gjithëpërfshirës për nxënësit në të gjithë vendin. Gjatë kësaj periudhe janë vendosur 240 oficerë sigurie në shkolla, të cilët trajnohen në mënyrë të vazhdueshme nga Akademia e Sigurisë⁶.

Masa 3.1.2 është e realizuar.

Masa 3.1.3. Fuqizohen programet që u mundësojnë të rinjve të përfshirë në grupe të dhunshme ose të radikalizuara të braktisin dhunën duke propozuar të ashtuquajturat "strategjitë e daljes".

Në kuadër të thirrjes publike Nr. III financuar nga MSHRF dhe AKR, Qendra për Formim dhe Zhvillim ka zbatuar projektin me titull “Parandalimi i dhunës dhe i krimit të Rinjtë përmes sensibilizimit dhe edukimit ligjor mes bashkëmoshatarësh”, i cili nëpërmjet krijimit të 7 fokusgrupeve me nga 7 persona në 3 Bashkitë Kucovë, Lezhë dhe Sarandë ku janë zhvilluar seanca trajnimi dhe workshope.

Masa 3.1.3 është pjesërisht e realizuar.

Masa 3.1.4. Promovohen programet për të rinjtë në masa reformuese duke vendosur mekanizma riintegrimi dhe mbështetje e aftësive për punësim, integrimin përmes punës në komunitet dhe mbështetje psikologjike dhe sipërmarrjeve sociale.

⁶ Për më shumë informacione klikoni në këtë faqe: <https://arsimi.gov.al/240-oficere-sigurie-ne-shkolla-manastirliu-733-incidente-me-pak-ne-shkolla-forcojme-rrjetin-e-sigurise-per-parandalimin-e-fenomeneve-negative/>

Masa 3.1.4 nuk është e realizuar

Masa 3.1.5 Përmirësohen me qasje specifike rinore, miqësore dhe të pranueshme, programet që trajtojnë migrimin e parregullt dhe trafikimin e qenieve njerëzore me në fokus parandalimin e këtyre fenomeneve dhe kthimin e të rinjve në shkollë, trajnim ose punë.

Ministria e Brendshme ka hartuar Strategjinë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe Planin e saj të Veprimit 2024-2026, i cili është përgatitur në vijim të strategjisë kombëtare për migracionin 2019-2022, që përfundoi afatin e zbatimit në dhjetor 2022.

Vizioni për migracionin është që deri në vitin 2030, në frymën e proceseve globale të migracionit dhe integritit të Shqipërisë në BE, të jepet një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj sfidave dhe mundësive të migracionit”.

Në linjë me këtë vizion, objektivi kryesor strategjik është “Qeverisja efektive e migracionit në Shqipëri, nëpërmjet adresimit dhe menaxhimit të problemeve dhe sfidave që dalin nga lëvizjet e migrantëve, me synim rritjen e ndikimit të migracionit në zhvillimin e vendit, në dobi të emigrantëve dhe shoqërisë shqiptare”.

Qeveria shqiptare synon të realizojë objektivin kryesor strategjik duke u fokusuar në tre qëllime kryesore politike: Garantimin e qeverisjes strategjike të migracionit, zhvillimin e politikave efektive për migracionin për arsye punësimi, duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit në zhvillimin socio-ekonomik kombëtar/lokal, si dhe promovimin e migracionit të rregullt, mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe integrimin e tyre në shoqërinë shqiptare.

Në kuadër të Promovimit dhe ndërjegjësimit të të rejave dhe të rinjëve për programet anti-korrupsion dhe rritjen e transparencës në vendim-marrjen rinore MSHRF dhe AKR ka financuar në Thirrjen publike Nr. III për organizatat rinore/për të rinjtë, organizatën "New Bridges" për zbatimin e projektit "Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje modelon të ardhmen". Gjatë implementimit të këtij projekti, në datat 12 dhe 13 Shkurt 2024, në qytetin e Beratit, u zhvillua trajnimi 2-ditor me temë “Shkrim mini-projektsh”, në të cilin u diskutua mbi advokimin dhe lobimin përmes shkrimit të projekteve. Në këtë trajnim morrën pjesë 17 (shtatëmbëdhjetë) të rinj të shkollave të mesme të Beratit.

Masa 3.1.5 është e realizuar

Masa 3.1.6 Fuqizohen programet rinore që fokusohen në të drejtat e njeriut dhe të pakicave, antikorrupsionin, barazinë gjinore, pranimit të diversitetit, tolerancës dhe komunikimit jo të dhunshëm.

Nëpërmjet thirrjes publike nr.III financuar nga MSHRF dhe AKR Organizata: “Qendra Shqiptare për Intergrimin e Njerëzve me Nevoja të Veçanta “ zbatoi projektin me titull “Çelësi i Harmonisë”, Promovimi i Mirëqenies Sociale dhe Shëndetit Mendor të Qëndrushëm tek të Rinjtë”. Qëllimi i këtij projekti është të ndërhyjë në përmirësimin e situatës së të rinjve në Bashkitë Elbasan, Belsh, Peqin dhe Cërrik, në aspektin e mirëqenies sociale, shëndetit mendor dhe aktivitetit fizik. Të mbështesë fëmijët me nevoja të veçanta, prindërit për nevojat e fëmijëve të tyre, institucione të arsimit publik dhe qendra shëndetësore.

Disa aktivitete të zhvilluara:

Në datë 23 dhe 24 Janar u zhvillua takim me organizata jo-fitimprurëse rinore të cilat janë shpallur fituese të Thirrjes Nr. III për grante nga AKR. Qëllimi i takimeve ishte ndërveprimi dhe bashkëpunimi për zbatimin e projekteve fituese.

Në datën 11 Prill, AKR mirëpriti të rinjtë nga grupet “IMPACT” në Tiranë dhe Kamëz të cilët u njohën me programet që AKR zhvillon si dhe mundësitë e ndryshme që ofrohen për të rinjtë, me fokus gjithëpërfshirjen, luftën kundër bullizmit dhe barazinë gjinore, etj.

Më datë 23 Shkurt është realizuar një takim me përfaqësuesit e Qendrës së “Rinisë Ruralë” ku morën pjesë të rinjtë nga Shkodra, Tiranë, Dibër, Pukë, Durrës, Fushë - Arrëz. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi dhe adresimi i problematikave që hasim të rinjtë e zonave rurale.

Në kuadër të mbështetjes së aktiviteteve të organizatave rinore për të drejtat e njeriut dhe të pakicave, barazinë gjinore, pranimit të diversitetit, tolerancës dhe komunikimit jo të dhunshëm, në datë 20 Maj AKR realizoi një takim me përfaqësuesit e "Qendra për Advokim Social", znj. Romina Sefa dhe Xhuljana Sakollari. Gjatë këtij takimi u diskutua lidhur me mundësitë për bashkëpunim dhe fuqizimin e të rinjve të komunitetit rom dhe egjiptian si dhe janë përcaktuar realizimi i aktiviteteve të përbashkëta në mbështetje të këtij targetgrupi.

Masa 3.1.6 është e realizuar

Masa 3.1.7 Fuqizohen programet dhe aktivitetet rinore, që trajtojnë çështje në lidhje me format e ndryshme të diskriminimit kundrejt identiteteve socio-kulturore, fetare, seksuale dhe të tjera

Organizata: “Qendra You Are Not Alone” shpallur fituese në thirrjen publike nr.III ka zbatuar projektin me titull “ROMActivism”, qëllimi i të cilit është të kontribuojë në përmirësimin e përfshirjes sociale të të rinjve nga komuniteti rom dhe egjiptian duke i mbështetur të integrohen në tregun e punës, duke i fuqizuar për tu mbrojtur nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes, si dhe duke rritur aktivizmin e tyre qytetar përmes bashkëpunimit me Këshillat Vendore Rinore (KVR). Projekti është shtrirë në Bashkitë Peqin, Cërrik & Elbasan


Aktivitet ndërgjegjësues dhe informues në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Dhunës dhe Diskriminimit, të realizuara pranë ambienteve të Qendrës Multifunkionale të Bashkisë Berat me pjesëmarrjen e nxënësve, mësuesve, të rinjve të Qendrës Rinore, përfaqësues të Zyrës kundër Dhunës në Familje dhe Barazisë Gjinore, të Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Trajtimi i rasteve të denoncuara dhe ekspozimi i rasteve të suksesit.

- Takime informuese me nxënës të arsimit të mesëm të lartë të IAP-ve, me të rinjtë e organizatave rinore pranë Bashkisë, përfaqësues të Qendrës Multifunkionale, mësues, prindër, drjtues të IAP-ve, përfaqësues të Qendrës “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve përkatëse dhe publikut të gjerë në lidhje me situatën aktuale të diskriminimit me bazë gjinore në Shqipëri.

- Fushata sensibilizuese me tematikë: “Dëgjo, beso, mbështet të mbijetuarit e dhunës”, “Bëjeni lagjen tuaj portokalli”, “Jepini fund dhunës kundër grave dhe vajzave tani” me pjesëmarrjen e nxënësve, mësuesve, prindërve, përfaqësuesve lokalë, të rinjtë e këshillave vendore rinore pranë Bashkisë Berat, përfaqësues të Shoqatës Gender “Paqe dhe Siguri” në kuadër të ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore.

Masa 3.1.7 është e realizuar

Përmbledhje për Objektivin Specifik 3.1



Objektivi Specifik 3.2: Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale

Masa 3.2.1 Bashkërendohet Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2021-2030, Agjenda e Fëmijëve 2021 – 2026, planet e veprimit dhe strategjitë e tjera lidhur me to, me masat e propozuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë, në veçanti promovimin e jetesës së shëndetshme

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kanë realizuar një sërë aktivitete në kuadër të zbatimit të objektivave të përbashkët të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 dhe Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026, duke përfshirë këtu promovimin e sportit për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, panairë sportive, aktivitete të shumëllojshme që lidhen me promovimin e artit, kulturës lokale dhe kombëtare, mbështetjen e mirëqenies fizike, sociale, kulturore dhe mendore të të rinjve, etj., në kuadër të thirrjeve për rininë të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, etj.

Nëpërmjet thirrjes publike Nr.III për projekt-propozime për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, MSHRF dhe AKR kanë mundur realizimin e një sërë aktivitete me qëllim nxitjen e ushtrimit të sporteve mes të rejave dhe të rinjve ku inkurajohet më shumë aktivitet fizik në jetën e përditshme të të rinjve.

Federata Shqipëtare e Skive ka zbatuar projektin me titull “Të Gjithë në Borë” duke realizuar trajnime të vazhdueshme me të rinj në Elbasan, Kukës, Durrës dhe Tiranë me qëllim përvetësimin e teknikave të sporteve dimërore. Projekti u finalizua në Dardhë të Korcës. 100 të rinj, të cilët kanë përvetësuar këtë sport dimëror dhe kanë mësuar teknikat nga trajnerë profesionistë.

Në muajin Prill 2024 u realizua takimi me përfaqësuesit e Qendrës për Advokim Social. Në takim u theksuan pikat e bashkëpunimit me AKR-së, duke u nisur nga nisma të vogla, si dhe u vendos për realizimin e aktivitetit të përbashkët mbi "Edukimin joformal nëpërmjet teknologjisë dhe sportit për gjithë përfshirje Sociale".

Në muajin Maj 2024 u zhvillua një takim me të rinjtë e Akademisë së Arteve Marciale në Shqipëri "Shaolin Kung Fu-Albanian Academy". Ky takim solli frymën dhe disiplinën e arteve marciale në ambientet e AKR-së dhe riktheu edhe njëherë vëmendjen tek mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve.

Organizata Mega Art ka zbatuar e projektit "Tradita në Lëvizje". Përgjatë muajve Shkurt dhe Prill 2024, në kuadër të projektit organizata ka zhvilluar workshope në qytetet e Librazhdit dhe Krujës. Qëllimi i workshop-eve ishte afrimi i të rinjve me traditën duke i edukuar ata mbi vullnetet të ndryshme dhe historikun e tyre. Ky projekt shtrihet në 10 qytetet e Shqipërisë.

Organizata "The Door" ka zhvilluar projektin me titull "Rinia në Veprim" i cili synoi përfshirjen e 150 të rinjve në bashkitë Shkodër, Pukë, Vau i Dejës, Malësi e Madhe nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme me qëllimin për të informuar dhe sensibilizuar mbi vlerat kulturore të traditës popullore.

Shoqata studentore "Sport dhe Rekreacion" zbatoi projektin "Adventure Sport & Mental and Physical Health in Youth" me target 300 studentët më të mirë të gjimnazeve të Tiranës, me të cilët u synua puna në grup për aftësimin në zgjidhje problemesh dhe vendim-marrjesh dhe për afrimin e të rinjve me natyrën. Projekti u zhvillua në bashkitë Himarë – Jalë, Liqeni i Farkës, Kepi i Rodonit, Liqeni i Fjollës.

Fondacioni "Qendra MAM" zbatoi projektin "Porta e Fjalës" ku u synua organizimi i shfaqjeve me 20 persona në grup gjithpërfshirës me nxënës dhe artistë. Shfaqjet dhe diskutimet u realizuan në bashkitë Shkodër, Durrës dhe Kamëz.

Masa 3.2.1 është e realizuar

Masa 3.2.2. Zhvillohen qasje të pranueshme dhe miqësore për të rinjtë në strukturat shëndetësore, të cilat marrin në konsideratë tranzicionin nga strukturat dhe shërbimet mjekësore për fëmijë te ato për të rriturit (nevoja për të zhvilluar standarde miqësore për të rinjtë) 2023-2029.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka zhvilluar aktivitete sistematike mbi sjelljet e shëndetshme, të cilat kanë trajtuar tema të tilla si këshillimi për duhanin, alkoolin, drogat, seksin e sigurtë etj., me përfshirjen e të rinjve dhe profesionistëve të kujdesit parësor.

Gjatë muajit prill, Komiteti Ndërsektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga produktet e duhanit, në mbledhjen e zhvilluar në ambientet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale konsideroi me rëndësi vijimin e një fushate ndërgjegjësimi për efektet e dëmshme të duhanit, si dhe një fushatë promovimi për dekurajimin e përdorimit të produkteve të duhanit veçanërisht tek të rinjtë.

Në vijim të këtij takimi u vendos:

- Të shtrihet në të gjithë vendin fushatë e zgjeruar sensibilizuese për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit në bashkëpunim me të gjitha institucionet;

- Të promovojë programe dhe projekte informuese dhe edukuese në shkolla, për rreziqet dhe dekurajimin e përdorimit të produkteve të duhanit tek të rinjtë me qëllim mbrojtjen e shëndetit;
- Thëllimin e bashkëpunimit me institucionet qeveritare për rishikimin e qasjes dhe politikave për reduktimin e dëmit që i kanoset shëndetit nga duhanpirja. Në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Policinë e Shtetit të vijnë kontrollet brenda dhe jashtë ambienteve të shkollave dhe gjimnazeve, të jenë nën monitorim të vazhdueshëm, edhe kundrejt ambulantëve për parandalimin e shitjeve të produkteve të duhanit tek të rinjtë.⁷

Masa 3.2.2 është masë pjesërisht e realizuar.

Masa 3.2.3. Zhvillohen shërbime të reja dhe forcohen ato ekzistuese nëpër shkolla me cilësi të garantuar për ofrimin e mbështetjes për shëndetin mendor dhe psikologjik, si edhe mbështeten shërbimet online të shëndetit mendor në platformën për rininë (të rinjtë për të rinjtë) 2023-2029.

Nën koordinimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë zhvilluar takime ndërgjegjësuese mbi nevojat e shëndetit mendor të të rinjve, me përfaqësues të qendrave komunitare. Janë përgatitur materiale informative dhe është organizuar trajnim për profesionistët shëndetësor të shkollave, ku janë përfshirë mbi 12 module, mes të cilave është edhe shëndeti mendor i të rinjve. 60 mjekë shkollash janë trajnuar gjatë periudhës raportuese.

Me mbështetjen financiare të AKR dhe MSHRF-së, Qendra Shqiptare për Integrimin e Njerëzve me Nevoja të Veçanta (QSHINJNV), organizoi aktivitetin “Panairi i shëndetit mendor” pjesë e projektit “Çelësi i Harmonisë”. Ky panair ofroi informacion dhe burime për të kuptuar dhe për t’u kujdesur dhe për të promovuar mirëqenien e shëndetit mendor. Espertë të shëndetit mendor, psikologë dhe profesionistë të tjerë mbajtën prezantime temat e ndryshme të shëndetit mendor tek të rinjtë përballë një audience gjithëpërfshirëse.

Masa 3.2.3 është masë pjesërisht e realizuar

Masa 3.2.4. Sigurohet pranimi i të rinjve në shërbimet e duhura të parandalimit dhe promovimit sipas Planit Kombëtar të Veprimit mbi Shëndetin dhe të Drejtat Seksuale dhe Riprodhuese 2022 - 2030, për të siguruar që të rinjtë që jetojnë në Shqipëri marrin edukim/informacione të përgjithshme në formë të pranueshme dhe miqësore ndaj tyre 2023-2029.

Janë përgatitur materiale informative dhe është organizuar trajnim për profesionistët shëndetësor të shkollave, ku janë përfshirë mbi 12 module, mes të cilave është edhe shëndeti riprodhues i të rinjve. 60 mjekë shkollash janë trajnuar gjatë periudhës raportuese.

Gjithashtu, janë hartuar materiale informuese për HPV dhe janë organizuar aktivitete ndërgjegjësuese me të rinjtë në shkolla, me qëllim informimin për HPV.

⁷ Për më shumë informacione klikoni në këtë faqe: <https://shendetesia.gov.al/kociu-forcim-kontrolleve-per-ndalimin-e-shitjes-se-produkteve-te-duhanit-afer-shkollave/>

Gjatë periudhës raportuese, ekspertët të ASCAP dhe ISHP kanë hartuar dhe është shpërndarë manuali mbështetës për stafin psikosocial në shkolla, mbi diskutimin për çështje të shëndetit mendor me nxënësit, ku është përfshirë dhe një kapitull mbi imazhin trupor dhe udhëzime mbi zhvillimin e ushtrimeve në klasë për rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve mbi imazhin pozitiv trupor.

Masa 3.2.4 është masë e realizuar

Masa 3.2.5 Propozohen dhe zhvillohen veprimtari në lidhje me sjelljen e rrezikshme dhe konsumin e drogës duke siguruar që të rinjtë marrin informacione dhe edukim tërësor. Sigurohet që të rinjtë kanë akses në ndërhyrjet e duhura parandaluese dhe shërbimet e trajtimit të varësisë 2023-2029

Në kuadër të programeve të edukimit për të rinjtë në lidhje me konsumimin e drogave dhe sjelljeve të rrezikshme, rifreskohen nga specialistët e institucioneve përkatëse dhe zbatohen nga të rinjtë, Qendra për Formim dhe Zhvillim (CFD), më kuadër të projekti “7 here 7 - Parandalimi i dhunës dhe krimit tek të rinjtë përmes sensibilizimit dhe edukimit ligjor mes bashkëmoshatarët” zbatoi me të rinjtë e shkollave të Sarandës projektin ku 51 të rinjtë u trajnuan me ekspertë të ligjit dhe punonjës social rreth kodit për Drejtësi Penale për të Mitur me qëllim parandalimin e krimit në moshat e hershme.

Masa 3.2.5 është masë e realizuar

Përmbledhje për Objektivin Specifik 3.2



Objektivi Specifik 3.3: Të rejat dhe të rinjtë mbështeten në përfshirjen dhe integrimi në tyre në shoqëri dhe kanë mundësi rekreative dhe kulturore, duke përfshirë artet dhe sportet

Masa 3.3.1 Mbështetet ndërtimi, riparimi dhe rinovimi i hapësirave publike të projektuara për të rinjtë, me qëllim përmirësimin e qasjes së të rinjve në hapësira të sigurta takimi, edhe në kohën e lirë.

Në kuadër të thirrjes III të AKR për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore:

1. “Skyhigh Rinor: Projekti i hapësirës së Rinisë që Shkëlqen mbi Qytet”- Bashkia Fier
2. “Rinovart, Qendër rinore multifunksionale, rekreative, inovacion dhe art”- Bashkia Mat
3. “Kompleksi Rinor “Syri i Sheganit”- Bashkia Malësi e Madhe
4. “Ndërtimi i një qendre rinore në Bashkinë Librazhd” - Bashkia Librazhd
5. “Rehabilitimi i Qendrës Rinore Korçë – Bashkia Korçë
6. “Qendra Rinore Sarandë” - Bashkia Sarandë

Më 29 Janar 2024, në qytetin e Dibrës u inagurua salla e leximit të bibliotekës. Kjo sallë, pranë Pallatit të Kulturës është realizuar me financimin e Agjencisë Kombëtare të Rinisë.

Në datën 2 Shkurt 2024, me financimin e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, në qytetin e Gjirokastrës u inagurua qendra e re multifunkionale e quajtur “Try Gjirokastra”.

Në kuadër të thirrjes Nr.II për projekte për infrastrukturë rinore financuar nga MSHRF dhe AKR më 29 Janar, u inagurua salla e leximit të bibliotekës në qytetin e Dibrës dhe në datën 2 Shkurt, në qytetin e Gjirokastrës u inagurua qendra e re multifunkionale e quajtur “Try Gjirokastra”.

Masa 3.3.1 është masë e realizuar.

Masa 3.3.2 Mbështetja e programeve të gjithëpërfshirjes dhe politikave të përfshirjes, sigurisë dhe mbrojtjes me fokus të veçantë tek të rejtat dhe të rinjtë.

Projektet fituese të thirrjes Nr. 3, AKR për projekt-propozime rinore që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me mbështetjen e organizatave rinore në zhvillimin dhe zbatimin e shërbimeve dhe programeve parandaluese për të rinjtë në rrezik të përjashtimit social, janë:

Organizata: “Qendra Youth Rise” – ka përfunduar zbatimin e projektit me titull: “*Unlock Your technological Skills*”. I cili ka qëllim krijimin e një mjedisi mbështetës për të rinjtë duke promovuar aftësitë inovative, digjitale dhe sipërmarrëse. Nga zbatimi i këtij projekti kanë përfituar 150 të rinj nga të cilët 30% e pjesëmarrësve janë nga grupet e marxhinalizuara.

Organizata: “Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (CRCA/ECPAT Shqipëri)” – është duke zbatuar projektin me titull “*Një ndalesë për shërbime rinore të integruara*”. me qëllim nxitjen e një Qeverisje lokale efektive dhe gjithëpërfshirëse që garanton mbështetjen, fuqizimin dhe pjesëmarrjen në jetën sociale dhe ekonomike të të rinjve në Bashkitë Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll. Nga ky projekt kanë përfituar dhe vazhdojnë të përfitojnë rreth 2000 të rinj e të reja në Bashkitë Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll (të paktën 200 të rinj e të reja nga grupet në nevojë, nga komuniteti Rom/Egjiptian/PAK, LGBTI etj.) (50% je grupit të synuar janë vajza) përfitojnë shërbime të drejtpërdrejta të këshillimit, mbështetjes dhe fuqizimit, informacion në punësim, shkollim, biznes rinor, shërbime shoqërore dhe ato të shëndetit mendor në Qendrën Rinore me një Ndalesë;

Organizata: Action for Albania - Titulli i Projektit: “*Action for Youth*”. Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është ngritja e kapaciteteve të të rinjve për aftësimin profesional si dhe monitorimi dhe mbështetja e ideve inovatore të sipërmarrjes (start upet), si aktivitet kritik për ndërlidhjen e të rinjve me tregun e punës, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të bashkive si dhe rritjen e mirëqenies së komunitetit. Grupi i synuar: Numri total i targetit të synuar: 300 të rinj të grup moshës 15-24. Programi i Sipërmarrjes dhe trajnimit: 60 pjesëmarrës ku 10 prej tyre i përkasin grupeve vulnerabël. (57% femra, 43% meshkuj).

Organizata: Qendra You Are Not Alone- (Donator UNFPA) - Titulli i Projektit: “*ROM Activism*”. Qëllimi i këtij projekti është përfshirja sociale e të rinjve nga komuniteti rom dhe egjiptian duke i mbështetur te integrohen në tregun e punës, duke i fuqizuar për tu mbrojtur nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes, si dhe duke rritur aktivizimin e tyre qytetar përmes bashkëpunimit me Këshillat Vendore Rinore (KVR). Grupi i synuar: 40-50 të rinj të moshës 15-19 vjeç, nga komuniteti ROM dhe Egjiptiane.

Në kuadër të Thirrjes nr. III për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë financiar nga MSHRF dhe AKR Shoqata “Ressegnatia” ka zbatuar projektin me titull “Aktivizimi dhe Nxjtja e të Rinjve për një Ambjent të Shëndetshëm dhe Social” i cili ka si qëllim informimin mbi aftësitë e nevojshme për të qënë aktivistë dhe iniciues të nismave mbi çështjet sociale duke synuar impaktimin e 300 të rinjve në Bashkitë Elbasan, Peqin dhe Belsh. Organizata ka zhvilluar sesione informuese dhe trajnime të vazhdueshme lidhur me rolin e të rinjve në çështjet sociale.

Organizata QSHINJNV, më datë 24 Prill, në kuadër të projektit "Çelësi i Harmonisë" financiar nga AKR dhe MSHRF, ka zhvilluar aktivitetin "Forumi për të drejtat e të rinjve me aftësi të kufizuara". Përgjatë forumit u diskutua mbi sfidat dhe mundësitë e këtyrë të rinjve mbi integrimin në shoqëri.

MSHMS po zbaton Planin Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar 2021-2025 miratuar me VKM Nr. 276, datë 12.05.2021, ku trajtohet përfshirja sociale dhe aksesueshmëria për të gjithë grupet e aftësisë së kufizuar, si dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025, duke patur në fokus sensibilizimin.

Në datë 8 prill 2024, në ditën ndërkombëtare të Romëve, u organizuar Dialogu për Integrimin e Romëve ku morën pjesë ambasadori i Delegacionit të BE-së në Tiranë, Silvio Gonzato, autoritete qendrore dhe vendore, përfaqësues të trupit diplomatik, organizata ndërkombëtare, shoqërisë civile, studentë dhe aktivistë romë. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të përfshirjes sociale dhe punësimitin e pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane.

Masa 3.3.2 është masë e realizuar

Masa 3.3.3 Mbështetet dhe promovohet programi i qeverise në lidhje me mbështetjen financiare të strehimit për familjet e reja dhe në bashkëpunim me aktorë qeveritare qendrorë dhe vendorë, si edhe organizatat donatore. Nxitet zhvillimi i programeve të tjera në mbështetje të familjeve dhe cifteve të reja.

Në Qershor 2023 u miratuan nga Kuvendi i Shqipërisë ndryshimet në ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, ku për herë të parë u parashikua përfshirja në skemën e programit të subvencionit të interesave të kredive punonjësit e administratës publike.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese ka filluar puna për hartimin e akteve nënligjore, ku do të parashikohen procedurën, kriteret, apo dokumentacionet që duhet të plotësohen, për të aplikuar për programin e kredisë së lehtësuar për blerjen e banesës, për punonjësit e administratës publike.

Në fokusin të programit të strehimit, ndër të tjera janë edhe familjet e reja, dhe ndryshimet ligjore të sipërcituara parashikohet të priorizojnë përfitimin e tyre nga ky program.

Në zbatim të Ligjit nr. 22/2018 ‘Për strehimin social’ është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 19.06.2024 “Për miratimin e kuotave të reja përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve përfitues në administratën publike”. Në këtë vendim janë përcaktuar 300 kuota të përgjithshme të kredive të lehtësuara me interes 0 për administratën publike për vitin 2024.


Masa 3.3.3 është realizuar

Përmbledhje për Objektivin Specifik 3.2

NUMRI I MASAVE	TË PARAPORTUARA	TË RAPORTUARA
3	0	3
100%	0%	100%

NUMRI I MASAVE	PLOTËSISHT TË REALIZUARA	PJESËRISHT TË REALIZUARA	TË PAREALIZUARA
3	3	0	0
100%	100%	0%	0%

-  Të Paraportuara
-  Totali i Masave të Qëllimit
-  E Parealizuar
-  Pjesërisht e Realizuar
-  Totalisht e Realizuar



1. Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 ka parashikuar 19 treguesit e rezultateve, të cilët janë të ndarë për secilin qëllim politik. Më poshtë pasqyrohet performanca e zbatimit të SKR-së sipas treguesve, për çdo qëllim politik, të cilët janë të zbatueshëm për periudhën raportuese, duke sqaruar se, një pjesë e treguesve janë të matshëm në fund të vitit 2024 e në vijim.

QËLLIMI I POLITIKËS 1:

Të rejtat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financiar, ka të parashikuar 4 tregues të performancës, të cilët janë të matshëm për periudhën raportuese.

Treguesi 1.1.c: Ligji "Për Rininë" i rishikuar dhe miratuar

Puna për rishikimin e ligjit nr. 75/2019 ka nisur në gjashtë mujorin e parë të vitit 2023 me ndërmarrjen e procesit të vlerësimit të brendshëm nga MSHRF-ja dhe AKR-ja lidhur me zbatimin dhe ndikimin e tij, duke synuar analizën e situatës, identifikuar problematikën dhe nevojat për ndryshim në përputhje me zhvillimet e reja në fushën e rinisë.

Proçesi i rishikimit të ligjit për rininë do të ndjekë të njëjtën qasje të bashkëkrijimit të zbatuar në rastin e përgatitjes së Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe do synojë angazhimin dhe marrjen e kontributeve të aktorëve të jashtëm. Paketa e amendimeve të Ligjit nr. 75/2019 parashikohet të përgatitet, konsultohet publikisht dhe paraqitet në Këshillin e Ministrave, brenda vitit 2024.

Në kushtet kur, SKR 2022-2029 është miratuar në 26 tetor të vitit 2022, puna për rishikimin e ligjit ka mundur të fillojë menjëherë në fillim të vitit 2023, periudhë gjatë të cilit janë marrë masat e sipërcituara, në kuadër të kryerjes së analizës e situatës së zbatimit të ligjit dhe identifikimit të problematikave, konsideruar edhe procesin e hapur të konsultimeve me të gjithë palët e interesit, që ne vetvete si proces merr kohë.

Treguesi 1.1.d: Ligji "Për Vullnetarizmin" i rishikuar dhe miratuar

Gjatë vitit 2022 ka nisur proces konsultimi në nivel politik dhe teknik mes Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe rrjetit të organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në vlerësimin e zbatimit të ligjit nr. 45/2016 "Për vullnetarizmin", gjatë vitit 2020 e në vijim, me qëllim identifikimin dhe adresimin e të gjitha problematikave gjatë procesit të rishikimit ligjor.

Në përfundim të procesit të konsultimeve u vendos nisja e procesit të rishikimit tërësor të Ligjit nr. 45/2016 "Për vullnetarizmin" dhe nga një grup i përbashkët pune, me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe rrjetit të organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në këtë proces, ka nisur puna, duke synuar angazhimin e të gjitha resurseve të disponueshme dhe të dhënave të mbledhura gjatë dy viteve të fundit për përgatitjen e një ligji efektiv, të qëndrueshëm dhe të gjithë pranuar, që do përmirësonte strukturën e vullnetarizmit dhe krijonte një mjedis më mundësues për sektorin në Shqipëri.

Grupi i përbashkët i punës ka vijuar punën gjatë vitit 2023 për përgatitjen e propozimeve ligjore me synimin që paketa e plotë të jetë e përgatitur, e konsultuar publikisht dhe paraqitur në Këshillin e Ministrave, brenda tremujorit të dytë të vitit 2024.

Treguesi 1.2.b: Platforma rinore "Të rinjtë për të rinjtë" e ngritur, funksionale dhe e përditësuar

Strategjia Kombëtare e Rinisë ka parashikuar se, në fund të vitit 2022 duhet të ketë filluar përgatitja e procesit dhe infrastrukturës për ngritjen e platformës "Të rinjtë për të rinjtë".

Referuar raportimit nga institucioni përgjegjës, nuk rezulton të jenë ndërmarrë hapat e nevojshëm për përmbushjen e këtij indikator gjatë periudhës së monitorimit.

Treguesi 1.1.b: Numri i Këshillave Vendore të ngritur dhe funksionale (në nivel bashkie)

Në periudhën janar-qershor 2024, në bashkëpunim me Bashkinë e Vaut të Dejës në datë 6 Mars 2024 u krijua edhe KVR për këtë qytet. Me krijimin e KVR-së së Vaut të Dejës u finalizua krijimi i 61 KVR-ve në gjithë vendin.

QËLLIMI I POLITIKËS 2:

Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity). Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.

Treguesi 2.1.a: Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës sipas gjinisë

Instat percakton se te dhenat e Anketës së Forcës së Punës per vitin 2024 do te publikohen ne dhjetor 2024.

Treguesi 2.3.a: Shkalla e papunësisë së të rinjve (%) të ndarë sipas gjinisë

Instat percakton se te dhenat e Anketës së Forcës së Punës per vitin 2024 do te publikohen ne dhjetor 2024.

Treguesi 2.2.a: Numri i të rinjve që kanë marrë pjesë në programe shkëmbimi/mobiliteti arsimor

RYCO	500 të rinj
Supershkollat	280 nxënës
Inkubatori Rajonal për Sipërmarrjen Sociale (RISE)	30 të rinj
Western Balkans Meet Japan” (MIRAI	14 të rinj

Treguesi 2.3.b: % e të rinjve që janë përfshirë në programet e nxitjes së punësimit

	TE RINJ PERFITUES JANAR- QERSHOR 2024	TOTAL PERFITUES	%
PUNËSIM (NËPËRMJET ZYRAVE TË PUNËS)	523	175	33%
V.K.M 17 (PROGRAMI 2 FORMIMI NËPËRMJET PUNËS)	338	156	46%
V.K.M 17 (PROGRAMI 3 PRAKTIKAT E PUNËS)	929	896	96%
V.K.M 608 (PROGRAMI 4 MUJOR)	20	12	60%
V.K.M 608 (PROGRAMI 8 MUJOR)	515	158	31%
V.K.M 608 (PROGRAMI 12 MUJOR/ INFORMALITETI)	466	115	25%
V.K.M 535 (PUNËT NË KOMUNITET)	1,267	144	11%
V.K.M 348 (PROGRAMI I VETËPUNËSIMIT)	286	138	48%
TOTAL	4,344	1,794	41%

Ndërkohë, në vijim pasqyrohen në mënyrë të detajuar shifrat, sipas programeve të punësimit gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2023:

LLOJI I PROGRAMIT	NUMËR PËRFITUESISH		
	TOTAL PËRFITUES	15 - 29 VJEC	%
V.K.M 17 (PROGRAMI 1 PUNËSIMI)	382	109	29%
V.K.M 17 (PROGRAMI 2 FORMIMI NËPËRMJET PUNËS)	151	62	41%
V.K.M 17 (PROGRAMI 3 PRAKTIKAT E PUNËS)	457	438	96
V.K.M 608 (PROGRAMI 4 MUJOR)	0	0	7%0
V.K.M 608 (PROGRAMI 8 MUJOR)	51	16	31
V.K.M 608 (PROGRAMI 12 MUJOR/ INFORMALITETI)	133	31	23
V.K.M 535 (PUNËT NË KOMUNITET)	995	72	7
V.K.M 348 (PROGRAMI I VETËPUNËSIMIT)	235	98	42
TOTAL	2,404	826	34%

Treguesi 2.3.c: % e të rinjve që kanë filluar biznesin me mbështetjen financiare të shtetit

Përmbushja e treguesit për vitin 2024 do të përlogaritet në fund të vitit.

Qëllimi i politikës 3 – Mirëqenia dhe Përfshirja

Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)

Treguesi 3.2.c: % e nëpunësve publikë të trajnuar mbi ofrimin e shërbimeve miqësore për rininë

Ky treguesi ka si qëllim të masë shkallën e nëpunësve të trajnuar çdo vit mbi ofrimin e shërbimeve miqësore për rininë. Nga të dhënat e raportuara nga MSHMS dhe ASPA rezulton se për vitin 2024 nuk janë realizuar trajnime për nëpunës publikë në fushën e ofrimit të shërbimeve miqësore për të rinjtë. Si i tillë treguesi nuk rezulton i realizuar.

2. Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve, risqeve dhe hapat për të adresuar

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 është një dokument strategjik shumëdimensional, i cili synon të adresojë të gjithë çështjet e rinisë, duke parashikuar marrjen e masave për arritjen e objektivëve specifikë dhe qëllimeve politike, në drejtim të fuqizimit, gjithë përfshirjes, arsimit, edukimit, shëndetit fizik e mendor, punësimit, lëvizshmërisë, mobilitetit të të rinjve etj.

Në këtë kuadër, institucionet përgjegjëse dhe institucionet kontribuese, të cilat kanë detyrimin e marrjes së masave dhe realizimit të aktiviteteve konkrete, janë të shumta. Drejtimi, organizimi, menaxhimi i mirë i veprimtarisë së secilit institucion, në përmbushjen e detyrave të veta, dhe veçanërisht koordinimi i punës së të gjithë institucioneve të përfshira, me qëllim edhe shkëmbimin e informacionit dhe zgjidhjen e problemeve, janë pjesë e riskut të zbatimit të SKR-së dhe të monitorimit të zbatimit të saj.

E lidhur me sa më sipër shihet edhe fakti që, MSHRF-ja është institucioni që drejton procesin e zbatimit dhe monitorimit të SKR-së, dhe ekzistenca e stafit të reduktuar në numër të këtij institucioni është një risk që duhet të adresohet gjithashtu.

Për sa i përket, mungesës së numrit të mjaftueshëm të punonjësve të MSHRF-së, vlerësohet se, fuqizimi i Agjencisë Kombëtare të Rinisë, duke shtuar numrin e burimeve njerëzore, si institucioni në varësi të MSHRF-së, përgjegjës për zbatimin e politikave të rinisë, dhe konkretisht përgjegjës apo kontribues, në zbatimin e masave të parashikuara në SKR, është një nga hapat që duhet të ndërmerren. Në këtë kuadër, po përgatitet paketa ligjore, për propozimin e ndryshimeve strukturore të këtij institucioni, ku parashikohet edhe shtesa e punonjësve në organikën e AKR-së.

Rritja e kapaciteteve zbatuese dhe financuese, në sajë të numrit të shumtë të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në kuadër të SKR-së, si dhe faktit që zbatimi i tyre shpesh kërkon ekspertizë të veçantë, është një nga risqet e zbatimit të saj.

Sfidë ngelet marrja e masave të nevojshme për fillimin e menjëhershëm të punës për kryerjen e aktiviteteve në funksion të zbatimit të masave, të cilat nuk rezultojnë me realizueshmëri të lartë,

duke ndikuar kështu edhe në performancën e objektivit specifik dhe qëllimit të politikës ku bëjnë pjesë.

Bashkëpunimi me partnerët/aktorët e jashtëm, si donatorë, të cilët vënë në dispozicion të zbatimit të SKR-së dhe përmbushjes të aktiviteteve, burimet e tyre njerëzore dhe financiare, konsiderohet një vlerë dhe një nga pikat e forta të arritjeve të realizuara në kuadër të Strategjisë, dhe intensifikimi i këtij bashkëpunimi është një nga masat që duhet të ndërmerren për adresimin e mungesës së kapaciteteve zbatuese dhe financuese të SKR-së.

Me qëllim, që në të ardhmen, të përmirësohet dhe të rritet performanca e zbatueshmërisë të SKR-së, duhet të merren masat për kapërcimin e risqeve të cituara më lart, bazuar edhe në rekomandimet vijuese.

3. Konkluzione dhe rekomandime

Raporti i monitorimit 6-mujor, janar 2024 – qershor 2024, në zbatim të Planit të Veprimit, të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, është një dokument monitorues periodik që hartohet në përputhje me këtë plan veprimi. Ky Raport është në përputhje me strukturën e dokumenteve strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale për agjendën e mirëqeverisjes në kuadër të programimit IPSIS. Raporti jep një informacion mbi zbatueshmërinë e qëllimeve të politikës, të objektivave specifike të strategjisë, të realizueshmërisë së treguesve, sipas vlerave të synuara dhe ato të arritura, të zbatueshmërisë së masave (output/produkte), të parashikuara për arritjen e këtyre objektivave e të aktiviteteve konkrete të parashikuara.

Raporti jep një informacion specifik mbi realizueshmërinë e masave prioritare të planit të veprimit, problematika të hasura gjatë zbatimit, sfidat e institucioneve, si dhe një identifikim të masave të nevojshme korrigjuese për periudhat në vijim.

Raporti i monitorimit janar-qershor 2024, përmban të dhëna statistikore dhe analitike bazuar mbi evidenca të matshme dhe të verifikueshme, mbi raportimin e drejtpërdrejtë të institucioneve zbatuese, mbi raporte dhe informacione të publikuara, konsultim me të gjithë faktorët (zbatues dhe vlerësues të procesit) e të dhëna mbi raport progresin e treguesve mbi baza krahasimore për çdo objektivi të strategjisë.

Institucionet përgjegjëse dhe kontribuuese, gjatë periudhës raportuese, kanë dëshmuar gatishmëri për marrjen e hapave të menjëhershëm për zbatimin e masave të parashikuara, për çdo objektivi specifik dhe çdo qëllim politik, të këtij dokumenti të rëndësishëm strategjik, në fushën e rinisë.

Mbështetja nga partnerët ndërkombëtarë dhe vendas, gjatë periudhës raportuese, në aspektin e burimeve njerëzore apo financiare, ka qenë një faktor kyç në realizueshmërinë e masave dhe kryerjen e aktiviteteve për zbatimin e tyre.

Ndërkohë, mungesa e burimeve njerëzore; mungesa e buxheteve specifike për kryerjen e veprimtarisë së parashikuar; mangësitë në raportimin e veprimtarive të kryera nga institucionet përgjegjëse dhe kontribuuese, duke ndikuar në kryerjen e një analizë reale dhe të saktë të

zbatueshmërisë së planit të veprimit, janë faktorë që kanë çuar në mosrealizim të objektivave të parashikuar për periudhën e raportimit.

Në përfundim të këtij raporti, rekomandimet për vijueshmërinë e zbatimit të planit të veprimit lidhen me rezultatin e zbatueshmërisë së SKR-së në tërësi, si dhe me mangësitë e konstatuara në raportim. Në mënyrë të përmbledhur rekomandimet në përfundim të raportit të monitorimit janë:

- Të ndërmerren hapat e nevojshëm për zbatimin e masave dhe objektivëve specifikë, të cilët rezultojnë të porealizuara;
- Të intensifikohet bashkëpunimi mes institucioneve përgjegjëse dhe atyre kontribuese, të cilat kanë detyrimin e ndërmarrjes së hapave të caktuar për përmbushjen e masave të parashikuara dhe kryerjen e aktiviteteve përkatëse të lidhura me to, me qëllim rritjen e nivelit të realizimit të masave dhe të saktësisë së raportimit.
- Informacioni i raportuar duhet të përpunohet dhe dërgohet në përputhje me kategorinë e informacionit, të jetë faktik, të ketë evidenca të qarta dhe të dhëna analitike në përputhshmëri me raportet që prodhojnë institucionet përgjegjëse;
- Të sigurohet mbështetje financiare për masat që nuk ka buxhet për periudhën vijuese, nëpërmjet parashikimit në PBA ose nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit me donatorët;
- Të rritet niveli i bashkëpunimit me AMVV dhe bashkitë e vendit, si institucione të rëndësishme në zbatimin e disa prej masave të parashikuara në SKR në nivel vendor,
- Të merren masat e nevojshme, që përveç zbatimit të masave të parashikuara, të rritet, në të ardhmen, zbatueshmëria e treguesve për çdo objektiv specifik;
- Të konsolidohet metodologjia e raportimit dhe mekanizmat e parashikuar për kryerjen e monitorimit dhe vlerësimit të zbatueshmërisë së SKR-së;
- Të sigurohen trajnime për personat përgjegjës, që merren me monitorimin e strategjive, për të patur një raportim eficient, në kohë dhe në përmbajtje;
- Të evidentohen nga institucionet përgjegjëse problematikat e hasura në mos përmbushjen e masave dhe aktiviteteve, duke plotësuar në instrumentin e raportimit edhe vlerësimin e riskut.

4. Hapat e radhës

Përmirësimi i Koordinimit me Palët e Interesit:

Veprimtaria duhet të intensifikojë koordinimin me të gjithë palët e përfshirë, duke përfshirë institucionet, ministritë e linjës, organizatat rinore, të rinjtë, punonjësit rinorë, Këshillat vendore rinore dhe të tjerë. Një përpjekje e përbashkët për të siguruar një bashkërendim të ngushtë do të forcojë efektivitetin dhe implementimin e masave.

Rishikimi i Ligjit të Rinisë dhe Ligjit të Vullnetarizmit:

Masat duhet të zbatohen në përputhje me parashikimet dhe qëllimet e Strategjisë Kombëtare të Rinisë për periudhën 2022-2029. Rishikimi i Ligjit të Rinisë dhe Ligjit të Vullnetarizmit mund të konsolidojë bazën ligjore për zbatimin e masave dhe përmirësimin e mjedisit ligjor për rininë.

Përmirësimi i Sistemit të Monitorimit dhe Ndjekjes së Masave të Porealizuara:

Një sistem i përmirësuar i monitorimit duhet të implementohet për të vlerësuar progresin dhe për të ndjekur masat që nuk janë ende realizuar. Përveç kësaj, duhet të ndërmerren masa adekuate për të adresuar çështjet e identifikuara dhe për të përmirësuar ndjekjen e tyre.

Integrimi i Çështjeve të Rinisë në Procesin e Raportimit për Bashkimin Evropian:

Raportimi periodik në BE përfshin masat e parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë në kontekstin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian. Ky proces do të thellojë bashkëpunimin dhe koordinimin me partnerët evropianë dhe do të thellojë përfshirjen në proceset evropiane.

Vazhdimi i Impaktit tek të Rinjtë dhe Rishikimi i Masave:

Vazhdimi i vlerësimit të impaktit të masave të zbatuara në të rinjtë duhet të jetë një pjesë e rëndësishme e përpjekjeve. Për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm, është e rëndësishme rishikimi i masave sipas nevojave dhe aspiratave të të rinjve.